*Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve. " Nënvizojmë se nga ana e autoritetit tuaj kontraktor nuk është kërkuar në asnjë rast dorëzimi i katalogut në rast se mjetet janë me kontratë porosie dhe mbi të gjitha se katalogu duhet të jetë i firmosur nga palët. Është kërkuar vetëm deklarimi i specifikimeve teknike të qarta të mjeteve të cilat janë deklaruar në kontratën e bashkëpunimit. Sa më sipër, arsyeja e skualifikimit i referohet një kriteri të pa kërkuar dhe ndodhemi në kushtet e nenit 55 pika 2 "të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar ku parashikohet se "Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën jituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit. " Akoma më tej, katalogu i mjeteve i deklaruar nga ana jonë dhei dorëzuar në këtë procedurë prokurimi është një akt i prodhuesit dhe te drejten e firmës mbi të e ka prodhuesi ose distrnbutori i autorizuar prej tij dhe në asnjë rast palët nuk mund të nënshkruajnë mbi katalogun e një prodhuesi kur ne nuk shfaqemi as në rolin e distrubutorit të autorizuar dhe as të prodhuesit. Ne si shoqëri kemi nënshkruar Shtojcën mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike ku kemi deklaruar se kemi marrë dijeni për specifikimet teknike, përfshirë edhe të mjeteve, i kemi pranuar dhe plotësuar me anë dokumentacionit të dorëzuar.*
*Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.*
*5.8. Lidhur me pretendimin se: "Se katerti: Lidhur me mjetet e deklaruara me qera nga Shoqeria REJ sh.p.k: -Kontrata e qerase per fat/rom goma e lidhur ndermjet shoqerise "REJ" dhe "Flamur Hoxhaj " nuk eshte vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimit qe kerkohet ne dokumentat e tenderit. Eshte percaktuar qe afati I kontrates te qerase do te jete 5 vjet nga data e kontrates. Data e kontrates te qerase esht 01.02.2018. Pra perfundon ne 01.02.2023,rrjedhimisht para perfundimit te kontrates qe do te lidhet per kete objekt. GJithashtu kontrata e qerase nuk esh para noterit. -Kontrata e qerase per kamioncinen e lidhur ndermjet shoqerise "REJ" dhe Z.E.Suli nuk eshte vlefshme per te gjithe periudhen e realizim kontrates objekt i ketij prokurimi sic kerkohet ne dokumentat e tenderit. Eshte percaktuar qe afati I kontrates te qerase do te jete 5 vjet nga data e kontra Data e kontrates te qerase eshte 31.01.2018. Pra perfundon 31.01.2023, rrjedhimisht para perfundimit te kontrates qe do te lidhet per kete objekt. Gjithas kontrata e qerase nuk eshte lidhur para noterit" vierësojmë se nuk është I bazuar në ligj dhe i referohet një kriteri të pa kërkuar sa më sipër nuk qëndron.*
*5.6. Në shtojcën mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit është kërkuar Kur jane me qera te paraqiten: kontrata e qerase vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt :" ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit ,certifikaten e pronesise, certifikate): e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit. " Së pari në lidhje me pretendimin se për mjetin tip fadrome me goma, kontrata e qerase nuk eshte noteriale, sqarojme se referuar KVK ne asnje rast nuk parashikohet se kontrata e qerasë duhet të jetë notenale, por parashikohet vetëm fakti see në rast se mjetet janë me kontratë qeraje. Në nenin 55 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20. i 1.2006 "Për*

*prokurimin publik" të ndryshuar ku parashikohet se "Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit. " Sa më sipër, autoriteti juaj kontraktor po skualifikon ofertën e shoqërisë tonë duke iu referuar një kriteri i cili nuk është kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit. Akoma më tej, kontrata e mësipërme është lidhur në përputhje me parashikimet e Kodit Civil. Neni 801 i Kodit Civil parashikon se Qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t'i japë pales tjeter (qiramarrësit) një send të caktuar, në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar.*

*Pra, referuar Kodit Civil nuk parashikohet se kontrata e qerasë duhet të jetë noteriale si element i vlefshmërisë së saj. Pra, që të kërkohet kontratë noteriale, duhet të përmbushen kuhtet e nenit 197 të Kodit Civil ku parashikohet se Duhen të regjistrohen gjithashtu: a) kontratat e qiradhënies së sendeve të paluajtshme për një kohë mbi nëntë vjet; ndëkrohë, në rastin konkret kontrata qe qerasë është 5 vjet ndaj nuk shfaqet nevoja te jetë noteriale. Në lidhje me pretendimet për afatin e vlefshmërisë së kontratës, nënvizojmë se afati i qerasë së kontratës me z. F. Hoxhaj dhe E.Suli është me kusht, pra 5 vjet nga data e lidhjes së kontratës duke përfshirë njëherazi të gjithë kohëzgjatjen e kontratës. Gjithashtu, kriteri plotësohet edhe vetëm me kontratën e porosisë ku është deklaruar disponueshmëria e një mjeti tip fadromë me goma, për të cilën ju si autoriteti nuk keni ngritur në asnjë rast pretendime.*

*5.9. Lidhur me pretendimin se : Gjithashtu nisur nga sherbimet konkrete qe ka marre persiper te kryeje shoqeria Rej konkretisht: "Pastrim nga Debora+lmposje " "Mbledhje transport mbeturinash fshati ", duhej qe shoqeria Ref sh.p.k te disponontе te pakten dy borepastruese dhe tre makina tek transportuese me ngarkim jimdor per mbledhjen dhe evadimin e mbeturinave, me kapacitet mbajtes deri ne 7 ton, per trasportin e mbeturinave te jihatitisie eshte percaktuar ne specifikimet teknike. Gjykojmë se nuk është i bazuar në fakt dhe në ligj dhe si i tillë nuk qëndron.*

*5.10. Në shtojcën mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës se prokurimit autoriteti juaj kontraktor ka parashikuar: Borepastruese cope 2 ( dy ), te jene te pajisura me mekanizmin e hedhjes se kripes. 3. Makina teknologjike transportuese me ngarkim jimdor per mbledhjen dhe evadimin e 5. Makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor per mbledhjen dhe evadimin e* mbeturinave, me kapacitet mbajtes deri ne 7 ton, cope 3 ( tre ) .

*5.11. Në përmbushje të kriterit të mësipërm të kualifikimit, bashkimi i operatorëve ekonomikë "Rej" shpk & "TTA Alba Lam" shpk kanë lidhur akt marrëveshjen noteriale nr.302 rep dhe nr.212 kol datë 14.02.2018 me shoqërinë Erka BMC 2007 e cila shfaqet në cilësinë e distrbutorit zyrtar të prodhuesve, Tatco, Ford Cukurova, Isuzi Hunday , Kaisan për Maqedoninë dhe Ballkanin Perëndimor. Referuar kontratës së sipërcituar është kryer porosia dhe disponueshmëiia një herezi në rast të nënshkrimit të kontratës të 3 mjeteve tip borëpastmese si edhe të 4 mjeteve tip makina tranpostuese për mbledhjen dhe evandimin e mbeturinave. Nënvizojmë se vlerësimi i ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë kryhet në përputhje me kriteret e tenderit, nenin 46,53,S4,55 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Përprokurimin publik" të ndryshuar si edhe nenin 74 të VKM 914/2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Sa më sipër, në kontratën e porosisë dhe në përputhje me përqindjen e bashkëpunimit dhe elementët konkretë të*

*bashkëpunimit, shoqëria "Rej" shpk disponon kapacitetin teknik dhe mjetet e nevojshme përkryerjen e shërbimit.*
*Sa më sipër pretendimi nuk qëndron.*
*Gjithashtu theksojmë se edhe KPP gjithmonë ka arsyetuar se Autoriteti Kontraktor duhet të udhëhiqet nga parimi i mirëpërdorimit të fondeve publike dhe përfitimi i një produkti me cilësi të mirë dhe me çmim më të ulët, si edhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, aq më tepër në kushte kur kemi një përcaktim të qartë të kritereve dhe dokumentacionit që duhet të paraqitet, dokumentacion ky i cili provohet më së miri se operatori ekonomik ankimues e disponon.*
*Sa më sipër kërkojmë:*
*l. Pranimin e ankesës*
*2. Kualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë "Rej" shpk & "TT A Alba Lam" shpk*

II.5. Operatori ekonomik ankimues sqaron se nëpërmjest shkresës me nr. 1267/1 prot., datë 20.03.2018, për të cilën ka marrë dijeni në datën 28.03.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje, duke e pranuar pjesërisht ankesën dhe konkretisht vetëm në lidhje me arsyen e skualifikimit për numrin e punonjësve, duke argumentuar si më poshtë vijon:
*[...]*

*I. Lidhur me arsyen e skualifikimit per kontratat e ngjashme:*
*KSHA konstatoi: Ne dokumentet e tenderit shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik, pika l, ndryshuar me shtojcen ne dokumentat e tenderit date I8.0l.2018,eshte parashikuar shprehimisht: "[...]*
*2. Ne kontraten e bashkepunimit te shqerive Rej sh.p.k dhe T.T.A ALBALAM sh.p.k,date 19.02.2018, ne piken 6 te saj eshte parashikuar se : "Firma Rej shpk do te kryeje 9. 5 4% te vlerave te zerave te punimeve te preventivit, "T. T.A ALBA LAM" sh.p.k do te kryeje 90. 46% te vlerave te zerave te punimeve te preventivit. "*
*3. Bazuar ne 74 pika 3 te VKM 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publiK" ku percaktohet se: "-Kërkesat ekonomi/te, financiare, profesionale dhe ata teknike duhet të përmbushen nga I gjithe bashkimi, në perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne pune sherbim apo furnizim te percaktuar ne aktmarreveshje", shoqeria Rej sh.p.k duhet te paraqese sherbime te ngjashme ne vleren 13.617.l65 lek pa tvsh.*

*KSHA arsyeton se: Vertetimi nr. 79/1, datë 18.01.2018, i lëshuar nga Bashkia Pogradec nuk permban te gjitha elementet e kerkuar ne kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit. Se pari nuk ka te percaktuar nese kontrata eshte permbushur me sukses dhe se dyti nuk ka te dhena lidhur me perqindjen e punimeve te kryera nga shoqeria Rej sh.p.k, se treti informacionet qe jepen ne vertetim nuk perputhem me kontraten ku nga njera ana paraqitet nje kontrate e lidhur me bashkimin e shoqerive Rej sh.p.k dhe Shpresa sh.p.k dhe nga ana tjeter paraqitet nje vertetim ku citohet se sherbimi eshte kryer vetem nga shoqeria Rej sh.p.k.*
*Akoma me tej ne rast se i referohemi te dhenave te paraqitura ne Vendimin e KPP Nr 157/2017, rezulton se vertetimi i paraqitur ne tenderin e Bashkise Vlore pavaresisht se eshte per te njejten kontrate te lidhur me Bashkine Pogradec, i permban te dhena te ndryshme krahasuar me*

*vertetimin e paraqitur ne Bashkine Korce, lidhur me operatorin qe ka kryer sherbimin dhe vleren e kryer prej tij. Pra pretendimet e cituara me siper ne pikat a,b dhe c nuk qendrojne.*

*-Lidhur me situacionin e janarit 2018 te paraqitur nga shoqeria Rej sh.p.k,rezulton se ky situcaion nuk eshte i firmosur nga Autoriteti Koatraktor, konkretisht nga Kryetari i Bashkise (jo nga supervizori sic citohet nga ankuesi ) si rezultat nuk eshte I rregullt.*

*Lidhur me pretendimin se nuk eshte kerkuar qe situacioni te jete I firmosur, KSHA gjykon se situacioni dhe cdo dokument tjeter duhet te kete formen e kerkuar ligjore dhe nenshkrimin nga personat pergjegjes. Ne rast se ndjekim logjiken e ankuesit edhe ne rast se paraqitet nje kontrate e pa firmosur dhe vulosur nga personat pergjegjes eshte e rregullt sepse ne kriteret nuk eshte kerkuar qe kontrata te jete e firmosur. Per sa me siper KSHA arrin ne perfundimin se situacioni nuk eshte i rregullt per sa kohe nuk eshte i nenshkruar nga personat pergjegjes. Sa me siper pretendimi i ankuesit nuk qendron.*

*Per dokumentacionin e paraqitur per sherbimet e kontraktuara nga Komuna Udenisht, KSHA arsyeton se:*
*Pretendimi i cituar e piken "a" nuk qendron pasi Komisioni i Vleresimit te Ofertave nuk eshte shprehur se mungon vertetimi nga komuna Udenisht. -Ankuesi nuk ka paraqitur kundershtime lidhur me mungesen e firmes te supervizorit ne situacionet e Situacionet e muajit korrik 2015, gusht 2015, shtator 2015 dhe dhjetor 2016. KSHIA gjykon se situacionet dhe cdo dokument tjeter duhet te kete formen e kerkuar ligjore dhe nenshkrimin nga personat pergjegjes,si rezultat situacionet e muajit korrik 2015, gusht 2015, shtator 2015 dhe dhjetor 2016 nuk jane te rregullt. -Pretendimi i cituar ne piken" b" nuk qendron pasi Komisioni i Vleresimit te Ofertave nuk eshte shprehur qe jane paraqitur situacione vetem per periudhen janar 2015 por eshte shprehur se jane paraqitur situacioue vetem per periudhen Janar 2015-Prill 2017.*

*Per plotesimin e kriterit te sherbimeve te ngjashme nga shoqeria TTA ALBA LAM sh.p.k, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka arritur ne perfundimin se : "Vertetimi i paraqitur nga Shoqeria TTA ALBALAM per realizimin e sherbimeve te ngjashme nuk permban informacion lidhur me realizimin me sukses te sherbimit por vetem nje listim te kontratave te lidhura me Bashkine Tirane ne kundershtim me percaktimin e bere ne dokumentat e tenderit ku jane percaktuar elementet qe duhet te permbaje vertetimi te eilatjane : ~ kohëzgjatja e shërbimit ~ vlera e shërbimit të realizuar \si dhe permbushja me sukses e kontrates se sherbimit:*

*KSHA arsyeton se:*
*-Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar shprehimisht: "Vertetim nga Investitori ku të përcaktohet kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar si dhe permbushin me sukses e kontrates se sherbimit. " -Në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Neni 63, "Të drejtat e personit të interesuar", pika l.l pnmshikohet se: "Në rastin e ankesave për dokumentat e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit i njoftimit të kontratës në faqen e lntemetit të*

*Agjencisë së Prokurimit Publik".[...]. KSHA sqaron se në legjislacionin për prokurimin publik është parashikuar qartësisht e drejta e operatorëve ekonomikë për procesin e ankimlmit në lidhje me të gjitha fazat apo hapat që përfshijnë një procedurë prokurimi dhe konkretisht e drejta për t'u ankimuar që në fazën e parë për kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si edhe e drejta për t'u ankimuar në fazat e tjera në vazhdim që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave deri në lidhjen e kontratës. Për rrjedhojë, nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me këtë kriter, atëherë ky i fundit mund të kërkonte ndryshimin e tij mbështetur në nenin 63, pika 1.1 të ligjit të sipërcituar.*

*Lidhur me pretendimin ankuesit se nuk ka trajtim te njejte me operatorin ekonomik te kualifikuar, KSHA konstatoi se ky pretendim nuk qendron sepses se pari operatori ekonomik i kualifikuar nuk ka paraqitur vetem kontrata te realizuara me Bashkine Tirane dhes se dyti ne njerin nga vertetimet e leshuara nga Bashkia Tirane eshte cituar shprehimisht se "Gjate realizimit te ketyre kontrataveshoqeria Korsel,ka permbushin me korrektesi te gjitha detyrimet kontraktuale ndaj Autoritetit Kontraktor Bashkia Tirane.*

*Lidhur me arsyen e skualifikimit për numrin e punonjësve KSHA konstatoi se:*
*Shoqeria Rej sh.p.k pretendon se ka paraqitur vertetim Nr T00147698 date 24.02.2018 ku jane pasqyruar muajt dhjetor 2017 dhejanar 2018.*
*Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur rezultoi se nga shoqeria Rej shpk, pervec vertetimit Nr T000729l4 Datë, 04.01.2018 te cituar nga KVO, eshte paraqitur edhe vertetimi Nr T00147698 date 24.02.2018 ku per muajin dhjetor 217 jane deklaruar 349 kontribues dhe per muajin Janar 2018 jane deklaruar 103 kontribues. Per sa me siper pretendimi i ankimuesit qendron.*
*II. Lidhur me arsyen e skualifikimit për drejtuesin teknik:*
*KSHA arsyeton se:*
*Shoqëria Rej shpk ka paraqitur një deklaratë për drejtuesin teknik ku deklaron shprehimisht se: "Unë i nënshkruari Luan Kapri me cilësinë e Administratorit të operatorit ekonomik Rej shpk deklaroj se Drejtues Teknik për realizimin e plotë të objektit "Pastrimi dhe evadimi I mbetjeve urbane në Bashkinë e Korçës (Shërbimi i pastrimit) do të jetë: ing. Florenc Gora.*
*Gjithashtu edhe Shoqeria T.T.A ALBALAM sh.p.k ka paraqitur nje deklarate per drejtuesin teknik ku deklaron shprehimisht se: "Une i nenshkrnari Ilir MATA me cilesine e administratorit te operatorit ekonomik TTA A ALBA LAM sh.p.k, deklaroj se Drejtues Teknik per realizimin e plote te objektit .,Pastrimi evarlimi i mbetjeve urbane ne Bashkine e Korces do te jete Ing. Monika HAXHO (Kareco).*
*Per sa me siper rezulton se secili nga administratoret e shoqerive kane deklaruar nga nje drejtues teknik jo per pjesen e tyre por per realizimin e plote te objektit. Komisioni i Vleresimit te Ofertave ne vleresimin e bere nuk eshte shprehur se perben shkelje caktimi i dy drejtuesave teknike. Por ka cilesuar si shkelje faktin qe shoqeria Rej sh.p.k megjithese ka marre persiper te kryeje 9.54 % te sherbimit deklaron, jo si perfaqesuese e bashkimit te operatoreve por ne menyre individuale, qe drejtuesi teknik i deklaruar prej saj do te jete drejtues teknik per*

*realizimin e plote te objektit dhe jo per pjesen e sherbimit qe ka mane persiper te kryeje. Gjithashtu edhe shoqeria T.T.A ALBALAM sh.p.k megjithese ka marre persiper te kryeje 90,46% te sherbimit deklaron ne menyre individuale drejtuesin teknik per realizimin e plote te objektit. «Pretendimi i shoqerise Rej sh.p.k se ”anetaret e bashkimit te operatoreve ekonomike kane deklaruar Drejtuesin Teknik te kryerjes te sherbimit secili per pjesen e tij te marre persiper ne kontraten e bashkepunimit" eshte kontradiktor me pretendimin tjeter te tij se "Bashkimi i operatoreve ekonomike permbush kriterin e sipercituar edhe vetem me deklarimin e anetarit tjeter te bashkimit te operatoreve ekonomike dhe njeheras lider ne kete bashkim operatoresh. " Lidhur me sa me siper,ose sejcili prej anetareve te bashkimit deklaron nje drejtues teknik per pjesen e vet te sherbimit,ose perfaqesuesi i bashkimit te shoqerive deklaron nje drejtues teknik ne emer te bashkimit te shoqerive. Ne rastin konkret, anetari tjeteri bashkimit te shoqerive, shoqeria T.T.A ALBALAM sh.p.k, nuk mund te deklaroje nje drejtues teknik ne emer te bashkimit te shoqerive sepse kjo shoqeri nuk ka tager te beje dekalarata ne emer te bashkimit te shoqerive per sa kohe nuk eshte perfaqesuese me prokure e bashkimit te shoqerive. Termi "lider" i perdorur per shoqerine "T.T.A ALBALAM" sh.p.k,nuk eshte term ligjor. I vetmi term qe njeh ligji ne rastin e bashkimit te shoqerive eshte “perfaqesuesi i bashkimit te shoqerive" dhene kete rast perfaqesuesi i bashkimit te shoqerive eshte shoqeria "Rej"sh.p.k.*

*Gjithashtu pretendimi se autoriteti kontraktor mund te perzgjedhe njerin nga dy drejtuesit teknike te propozuar nuk qendron sepse ne kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit i kerkohet ofertuesve te deklarojne drejtuesin teknik dhe jo te propozojne nje drejtues teknik. - Ne rast se marrim te mireqene faktin pretendimin se sejcili prej anetareve te bashkimit ka deklaruar drejtuesin teknik sejcili per pjesen e vet atehere sejcili prej drejtuesve teknike te deklaruar duhet te permbushin kriteret e vendosura per drejtuesin teknik. Keshtu,shoqeria Rej sh.p.k ka deklaruar Z.Florenc Gora si drejtues teknik per te cilin ka paraqitur dokumentacionin si me poshte:*

*-Kontrate pune*

*- CV*

*- Letër reference*

*- Libreze pune*

*Kontrata e punes eshte lidhur ne daten 12.06.2017 dhe Z.Gora eshte me profesion ingMjedisi dhe eshte kontraktuar per kryerjen e detyres te drejtuesit teknik. Per sa me siper nuk qendron vleresimi i bere nga KVO se Z.Gora eshte kontraktuar si lng. Mjedisi dhe jo si drejtues teknik. Lidhur me eksperiencen 5 vjecare si drejtues teknik.bozunr ne letren e references Nr 06 pret te leshuar nga shoqeria "Paster'sh.p.k,rezulton se Z.Gora ka punuar si konsulent i jashtem ne pozicionin e ing.te mjedisit per periudhen 02.04.2009 deri ne 31.12.2014. Pra eksperienca e drejtuesit teknik te deklaruar nga shoqerin Rej sh.p.k eshte si konsulent i jashtem, pra jo me kohe te plote. Sic konstatohet edhe ne CV e paraqitur per periudhen 02.04.2009 deri ne 31.12.2014 ka qene i angazhuar ne disa pune te tjera qe nuk kane lidhje me sherbimin e pastrimit. Duke qene se kontrata e punes me shoqerine Rej sh.p.k eshte lidhur ne daten 12.06.2017,eksperienca e Z.Gora si drejtues teknik ne fushën e sherbimit te pastrimit rezulton te jete rreth 7 muaj. Ne keto kushte drejtuesi teknik i deklaruar nga shoqeria "Rej" sh.p.k, nuk*

*mund te konsiderohet se permbush kriterin e eksperiences 5 vjecare ne fushen e sherbimit te pastrimit. Per sa me siper KSHA vlereson se bashkimi i shoqerive "Rej"sh.p.k dhe "T.T.A ALBA LAM"sh.p.k , nuk permbush kriterin lidhur me drejtuesin teknik.*

*III. Lidhur me arsyen e skualifikimit: "Shoqeria REJ sh.p.k. nuk permbush kriterin e percaktuar ne dokumentat e tenderit.shtojca7,kriteret e vecanta te kualifikimit./kapaciteti teknik, pika IV, ku percaktohet shprehimisht: "I V. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te ketë të punësuar staf teknik i cili duhet të figurojë në listpagësat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, për punonjësit si më poshtë: 1 (një) Inxhinier Mekanik, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV dhe librezë pune. "Konkretisht mangesite e konstatura janë si me poshte: Ing. mekanik I shoqerise Raj sh. p.k nuk figuron 6 muajt e fundit ne listpagesa figuron vetem per Muajt Nentor 201 7, Dhjetor 2017, Janar 2018. "KSHA konstatoi se:*

1. *Ne kontraten e bashkepunimit te shoqerive Rej sh.p.k dhe T.T.A ALBALAM sh.p.k,date l9.02.2018,ne piken 7 te saj eshte parashikuar se : "Shoqeria Rej sh.p.k do te kryeje Pastrim rrugesh nga Debora+kriposje" "Mbledhje transport mbeturinash fshati, "Larja e kontenierev e + dizifektim.*

   *Bazuar në nenin 74 pika 3 te VKM 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit publik" ku percaktohet se: "-Kerkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në [...].*

   *Nga verifikimi i dokumentacionit te dorezuar rezulton se shoqeria "Rej"sh.p.k ka lidhur kontrate me Z.Tritan Mukollari, me profesion 1ng.Mekanik ne daten 01.06.2017. Nga verifikimi i listpagesave rezulton se pavaresisht se ka tilluar pune ne daten 01.06.2017, Z.Tritan Mukollari figuron ne listpagesa vetem per muajt Nentor 2017, dhjetor 2017 dhe Janar 2018, cka perben jo vetem shkelje te legjisacionit per sigurimet e punonjesve por dhe mospermbushje te kriterit te vendosur. Per sa me siper pretendimi i shoqerise Rej sh.p.k nuk qendron.*

   *I. Lidhur me arsyen e skualifikimit: "Bashkimi i shoqerive Rej sh.p.k dhe T.T.A ALBALAM sh.p.k nuk permbush kriterin e percaktuar ne dokumentat e tenderit,shtojca7,kriteret e vecanta te kualitikimit,kapaciteti teknik,pika pika XII ,ku percaktohet shprehimisht: "Operatori ekonomik duhet të paraqesë <u>një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve,</u> ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:*
   *1. 2 (dy) makina teknologjike përfshirjen e rrugëve (fshesa mekanike ), te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qëndrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës.*
   *2. Borepastruese cope 2 (dy), te jene te pajisura me mekanizmin e hedhjes se kripes.*
   *3. Makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor per mbledhjen dhe evadimin e mbeturinave, me kapacitet mbajtes jo me pak se 10 ton, cope 4 ( kater )*

*4. Makina kompatator per heqjen e mbeturinave ne lagjet pa kontenier,jo me shume se 3,5 ton, cope 3 ( tre ) .*
*5. Makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor per mbledhjen dhe evadimin e mbeturinave, me kapacitet mbajtes deri ne 7 ton, cope 3 ( tre ) .*
*6. Makina për larjen e rrugëve, (mjet teknollogjike) të pajisur me pompë për larjen e rrugëve me presion, pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesën anësore të tij, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10.0001itra ujë, jo më pak se 1 (nje) copë;*
*7. Makina për lagien e rrugëve (mjet teknollogjike) të pajisura me pompë për lagien e rrugeve, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10.000 litra ujé, jo më pak se 1 (nje) copë;*
*8. Fadrome me goma per heqjen e inerteve me kapacitet te koves jo me pak se 1 m3 ,cope 1 ( një).*
*9. Traktor per shtytjen dhe ngjeshjen e mbeturinave ne fushe cope 1 ( nje ) .*
*10. Makine transporti per mbetjet e riciklueshme (leter-plastike, qelq, alumin) me shenja dalluese, 1 (nje cope)*
*11. Kamioncine per evadimin e mbetjeve inerte, 1(nje) cope*
*[...]*
*KSHA konstatoi se:*

1. *Për plotesimin e kriterit te vendosur per mjetet bashkimi i shoqerive Rej sh.p.k dhe T.T.A ALBALAM sh.p.k ka paraqitur:*
   *Deklarate mbi disponueshmerine e mjeteve*
   *Deklarate mbi verifikimin e mjeteve*
   *Aktmarreveshje noteriale per sigurimin e mjeteve lidhur ndermjet bashkimit te shoqerive Rej sh.p.k dhe T.T.A ALBALAM sh.p.k dhe shoqerise Erka BMC 2007 sh.p.k*
   *Kontrate qeraje per fadromen me goma e lidhur ndermjet shoqerise "REI" dhe "Flamur Hoxhaj*
   *Kontratën e qerasë për kamioncinën e lidhur ndërmjet shoqërisë Rej dhe Z. Engjell Suli*
   *Vërtetim zhdoganimi traktori*
2. *Lidhur me aktmarrëveshjen për mjetet në kriteret e vendosura në dokumentat e tenderit është parashikuar shprehimisht: [...]*
   *Në aktmarrëveshjen noteriale për sigurimin e mjeteve lidhur ndërmjet bashkimit të shoqërive Rej dhe TTA Alba Lam dhe shoqërisë Erka BMC 2007 në pikën 4.3 është përcaktuar si më poshtë:*
   *4.3. [...]*
   *Në kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit është përcaktuar ndër të tjera që marrëveshja duhet të përmbajë të dhëna të sakta në lidhje me tiipin e mjetit, të dhënat teknike për mjetin.*
   *Nga krahasimi i të dhënave teknike të kërkuara për mjetet dhe ato të shënuara në aktmarrëveshje rezulton se nuk ka të dhëna teknike të plota për mjetet në mënyrë që të gjykohet që ato janë në përputhje me specifikimet të kërkuara për mjetet.*

*Sic shihet dhe ne tabelen përmbledhëse, karakteristikat e mjetit të shenuara me "bold" dhe te nenvizunra mungojne ne aktmarrëveshje. Per sa me siper KSHA arrin ne perfundimin se aktmarrëveshja per mjetet nuk përmban të dhëna te sakta në lidhje me tipin e mjetit dhe të dhënat teknike ne perputhje me dokumentat e tenderit. Pra nuk qendron pretendimi nnkuesit se ne aktmarrëveshjen e mjeteve janë deklaruar specifikime të qarta të mjeteve. Duke qenë se ne aktmarreveshje eshte cituar se "lista/tipi autmjeteve dhe kamionave eshte bashkelidhur me kete aktmarreveshje" cka nenkupton se eshte pjese e aktmarreveshjes, dhe ne kushtet kur ne pershkrimin e bere ne akmarreveshje mungonin karateristikat e disa prej mjeteve atehere me te drejte KVO ka verfikuar kataloget bashkelidhur. Per sa me siper verifikimi katalogeve ne kete rast nuk mund te interpretohet si verifikim i nje dokumenti te pa kerkuar. Ne rast se pranojme pretendimin e operatorit se kataloget nuk duhet te merren fare ne shqyrtim per arsye se nuk jane kerkuar atehere arrijme ne perfundimin se ne kushtet kur aktmarreveshja per mjetet nuk permban karakteristikat e kerkuara per mjetet, bashkimi i operatoreve nuk permbush kriterin e kerkuar per mjetet. Duke qene se palet kane cituar se "lista/tipi automjeteve dhe kamioneve eshte bashkelidhur me kete aktmarreveshje" nga verifikimi i dokumentacionit qe i eshte bashkelidhur aktmarreveshjes rezulton se per sa kohe qe ky dokumentacion nuk ka vule lidhese nga noteri apo konfirmim nga te gjitha palet se behet fjale per te njejtat mjete te cituara ne aktmarreveshje atehere ato nuk mund te merren ne shqyrtim per te vertetuar se permbushin karakteristikat e kerkuara ne dokumentat e tenderit.*
*Per sa me siper nuk qendron pretendimi i ankuesit nuk qendron.*

*Lidhur me mjetet e deklaruara me qera apo në pronësi të shoqërisë REj shpk KSHA Vlerëson se:*
*Nisur nga shërbimet konkrete që ka marrë përsipër të kryejë shoqëria Rej shpk*
*"Pastrim rrugesh nga Debora+kriposje",*
*"Mbledhje transport mbeturinash fshati"*
*"Larje e konteniereve + dizinfektim"" duhej qe shoqeria Rej sh.p.k te disrononte te pakten dy borepastruese dhe tre makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor per mbledhjen dhe evadimin e mbeturinave, me kapacitet mbajtes deri ne 7 ton, per trasportin e mbeturinave te fshatit,sic eshte percaktuar ne specifikimet teknike.*
*Per sa me siper vlefshmeria e dokumentacionit te paraqitur per mjetet "Fadrome me goma", kamioncine, apo traktor, nuk ka asnje vlere sepse edhe sikur dokumentacioni te jete i vlefshem ai nuk sherben per kualifikimin e kesaj shoqerie sepse jane mjete qe nuk kane lidhje me sherbimet qe shoqerin "Rej" sh.p.k ka marre persiper te kryeje sipas aktruarreveshjes te bashkepunimit.*
*1._ Lidhur me vleresimin e bere nga KVO per kontraten e bashkepunimit : "Ne Kontraten e bashkepunimit te shoqerive Rej sh.p.k dhe 'TTA ALBA LAM sh.p.k , pika 13 e kesaj kontrate ku percaktohet se " Kapaciteti ekonomik dhe teknik (mjetet dhe stafi teknik etj)] shoqerise Rej sh. p. k, do te jete ne dispozicion te bashkimit te operatoreve "TTA Alba Lam "sh.p.k dhe "Rej" sh.p.k ne rast se ky bashkim operatoresh shpallet*

*fitues .Per kete arsye nuk eshte pare e arsyeshme te behen kontrate qeraje per mjetet qe do te perdoren ne kete kontrate. Gjithashtu eshte e vlefshme edhe e anasjellta. ” eshte ne kundershtim me percaktimin e bere në nenin 74 pika 3 te VKM 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publiK” ku percatohet si me poshte: -Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga igjithë bashkimi. në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes për punë Shërbim apo furnizim të përcaktuara në aktmarrëveshje. Persa me siper duke qene se ne aktmarrevshjen noteriale te lidhur per furnizimin me makineri nuk eshte bere ndarja e tyre por marreveshja eshte bere nga bashkimi i shoqerive nuk mund te gjykohet nese sejcili nga anetaret e bashkimit e permbush kriterin e mjeteve ne perputhje me perqindjen qe ka marre persiper ne marreveshjen e bashkepunimit. " KSHA,vlereson se ne kushtet kur: -Ne nenin 74 pika 3 te VKM 914 date 29.12.2014 te cituar me siper vleresimi i permbushjes te kritereve nga sejcili prej anetareve te bashkimit te shoqerive behet në përputhje me përqindjen e vo’esëmarr'es në ”më shërbim ato itrnizim, të aërcaktuara në akt marrëvesh 'e. -Percaktimi i bere ne piken 13 te kontrates te bashkepunimit te shoqerive_Rej sh.p.k dhe T.T.A ALBALAM sh.p.k ,te siper cituar, eshte ne kundershtim me me nenin 74 pika 3 te VKM 914 date 29.12.2014. Ne aktmarreveshjen noteriale te lidhur per furnizimin me makineri nuk eshte bere ndarja e tyre por marreveshja eshte bere nga bashkimi i shoqerive, atehere nuk mund te gjykohet nese sejcili nga anetaret e bashkimit e permbush kriterin e mjeteve ne perputhje me perqindjen dhe elementet konkrete qe ka marre persiper ne marreveshjen e bashkepunimit.*

II.6. Në datën 28.03.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.
Në lidhje me kthimin e përgjigjes së bërë nga autoriteti kontraktor, operatori ekonomik ankimues sqaron, në ankesën e paraqitur pranë KPP-së, për pretendimin për kontratat e ngjashme, ka paraqitur bashkëlidhur edhe dokumentin Kontratë Partneriteti të lidhur ndërmjet shoqërisë “Rej” sh.p.k. dhe “Shpresa” sh.p.k. për kontratën e paraqitur si eksperiencë të mëparshme të lidhur ndërmjet këtij bashkimi operatorësh ekonomikë dhe Bashkisë Pogradec.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 1787/1 prot., datë 12.04.2018, të protokolluar me tonën në datën 16.04.2018, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

## III

## Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

## Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se arsyeja e skualifikimit : *Bashkimi I shoqerive Rej dhe T.T.A ALBALAM sh.p.k nuk permbush kriterin lidhur me sherbimet e ngjashme,te percaktuar ne dokumentat e tenderit,shtojca7,kriteret e vecanta te kualifikimit,kapaciteti teknik,pika I,ku percaktohet shprehimisht: "I.Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën: Shërbime të meparshme te ngjashme në një vlerë jo me pak se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës të realizuar gjatë tre viteve të fundit . -Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me ente publike, duhet te paraqiten: 1. Kontrate 2. Situacionet për punimet e kryera 3.Vertetim nga Investitori ku të përcaktohet kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar si dhe permbushja me sukses e kontrates se sherbimit. -Kur sherbimi i ngjashem eshte realizuar me sektorin privat, duhet te paraqiten: 1.Faturat tatimore perkatese, te konfirmuara (ku te shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara) 2. Situacionet për shërbimet e kryera".*
*Konkretisht mangesite e konstatura jane si me poshte:*
*1) Shoqeria REj ka paraqitur 2 kontrata. I-Kontraten me Bashkine Pogradec Lidhur me sa me siper ka paraqitur -Kontrate -Situacione -Vertetim Kontrata e paraqitur eshte lidhur ne daten 16.01.2015 ku pale jane Bashkia Pogradec dhe Bashkimi i shoqerive "REJ sh.p.k dhe Shpresa sh.p.k" me afat 5 vjecar duke filluar nga data 16.01.2015-15.01.2020. Gjithashtu eshte lidhur edhe nje kontrate shtese ne date 31.12.2015 me kete bashkim shoqerish. Ne kontrate nuk ka asnje te dhene lidhur perqindjen dhe sherbimet konkrete qe do te kryeje sejcila nga shoqerite ne menyre qe te vleresohet nese shoqeria Rej sh.p.k ploteson vleren e sherbimeve te ngjashme. Vertetimi i leshuar nga Bashkia Pogradec me Nr 79/1 date 18.01.2018 nuk ka te percaktuar nese kontrata eshte permbushur me sukses ,pra nuk ka nje vleresim per cilesine e sherbimit te kryer nga kjo shoqeri, per me teper ka konfirmuar qe,ne kundershtim me sa eshte percaktuar ne kontraten baze dhe ne ate shtese, sherbimi eshte kryer vetem nga shoqeria REJ sh.p.k. Situacioni I janarit 2018 nuk eshte I firmosur dhe vulosur nga Autoriteti Kontraktor,Bashkia Pogradec.*
*II.Kontrata me Komunen Udenisht Lidhur me sa me siper eshte paraqitur -Kontrate -Situacione -Vertetim Kontrata e paraqitur eshte lidhur ne daten 30.04.2012 me afat 5 vjecar ku pale kane qene Komuna Udenisht dhe Shoqeria REJ. Ne vertetim jepen te dhena per periudhen 30.04.2012-30.04.2015 dhe jane paraqitur situacione vetem per periudhen Janar 2015-Prill 2017. Vlera e situacioneve per kete periudhe eshte 5.443.193 lek,pa tvsh. Situacionet e muajit korrik 2015,gusht 2015,shtator 2015 dhe dhjetor 2016 nuk jane te firmosura nga supervizori.*
*Vertetimi I paraqitur nga Shoqeria T.T.A ALBALAM per realizimin e sherbimeve te ngjashme nuk permban informacion lidhur me realizimin me sukses te sherbimit por vetem nje listim te*

*kontratave te lidhura me Bashkine Tirane ne kundershtim me percaktimin e bere ne dokumentat e tenderit ku jane percaktuar elementet qe duhet te permbaje vertetimi te cilat jane :*
*- kohëzgjatja e shërbimit - vlera e shërbimit të realizuar -si dhe permbushja me sukses e kontrates se sherbimit*, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7 Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes, pika 2.2. Kapaciteti teknik, pika I, pas modifikimit të publikuar në Shtojcën përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri: "
*I.Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:*
*Shërbime të meparshme te ngjashme në një vlerë jo me pak se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës të realizuar gjatë tre viteve të fundit .*
-*Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me ente publike, duhet te paraqiten:*
*1. Kontrate*
*2. Situacionet për punimet e kryera*
*3.Vertetim nga Investitori ku të përcaktohet kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar si dhe permbushja me sukses e kontrates se sherbimit.*

-*Kur sherbimi i ngjashem eshte realizuar me sektorin privat, duhet te paraqiten:*
*1.Faturat tatimore perkatese, te konfirmuara (ku te shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara)*
*2. Situacionet për shërbimet e kryera*
III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Kontratë Bashkëpunimi, ndërmjet shoqërisë "Rej" sh.p.k. dhe shoqërisë "T.T.A. Alba Lam" sh.p.k., nga ku shoqëria "Rej" sh.p.k. merr përsipër të kryejë 9.54% të vlerave të zërave ë punimeve të preventivit dhe konkretisht zërat:
Pastrim rrugësh nga dëbora + kriposje;
Mbledhje dhe transport mbeturinash fshati;
Larje e kontenierëve + dizifenktim;
ndërsa shoqëria "T.T.A Alba-Lam" sh.p.k. merr përsipër të kryejë 90.46% të vlerave të zërave të punimeve të preventivit dhe konkretisht zërat:
shërbimi i pastrimit natën;
mirëmbajtja e rrugëve ditën;
fshirje e rrugëve me fshesë mekanike;
mbledhje dhe transport mbeturinash qyteti;
lagie e rrugëve;
larje speciale e rrugëve;
depozitim inertesh dhe roje e venddepozitimit të vjetër.
Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria "Rej" sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.
III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

Open Procurement Albania

- Kontratë nr. 1, datë 30.04.2012 lidhur mes Komunës Udënisht dhe operatorit ekonomik “Rej” sh.p.k. me objekt ”Për pastrimin dhe largimin e mbeturinave urbane nga Komuna”, me afat 5 vjeçar, me vlerë 3.487.980 lekë (me tvsh) ?? në vit ;
    - fatura tatimore shitje për muajt Janar 2015 – Prill 2017 (faturat janar 2015 – nëntor 2015 dhe Janar 2016 janë të nënshkruara vetëm nga shitësi), në shumën 5.757.692,5 lekë pa tvsh, nga të cilat në konsiderim të tre viteve të fundit përllogariten vetëm faturat për periudhën Shkurt 2015 – Prill 2017 (referuar tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit) vlera totale është 5.335.367,5 lekë pa tvsh;
    - situacionet për periudhën Janar 2015 – Prill 2017 (korrik 2015, gusht 2015, shtator 2015, dhjetor 2016 janë të nëshkruara vetëm nga sipërmarrësi dhe investitori;
    - Dokumenti ”Pajisje me vërtetim për realizimin e kontratës së pastrimit”, lëshuar në datën 20.02.2018, me nr. 349/1 prot., për operatorin ekonomik ”Rej” sh.p.k. nga Bashkia Pogradec, për kontratën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave urbane nga Komuna Udënisht për periudhën 30 Prill 2012 – 30 Prill 2017, ku konstatohet se vlera e realizuar për këtë shërbim është 11.549.734 lekë pa tvsh;
- Kontratë datë 16.01.2015 lidhur midis autoritetit kontraktor Bashkia Pogradec dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rej” shpk dhe “Shpresa” shpk, me objekt ”Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave publike të qytetit të Pogradecit”, me afat 5 vjeçar, me fond limit 198.062.504 lekë me tvsh,
    - fatura tatimore shitje dhe situacione për muajt Janar 2015 – Dhjetor 2015,
    - kontratë shtesë e lidhur në datën 31.12.2015, ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë ”Rej” sh.p.k. & ”Shpresa” sh.p.k., me afat nga data 31.12.2015 deri në datën 07.01.2018, me vlerë 1.198.178 lekë me tvsh; shoqëruar me faturë tatimore shitje dhe situacion;
    - faturat tatimore të shitjes dhe situacionet përkatëse për periudhën Janar 2015 – Janar 2018;
    - Dokumenti ”Konfirmim realizim shërbimi”, lëshuar në datën 18.01.2018, me nr. 79/1 prot., për operatorin ekonomik ”Rej” sh.p.k. nga Bashkia Pogradec, për kontratën e shërbimit të pastrimit për periudhën 17 Janar 2015 – 31 Dhjetor 2017, me vlerë realizimi në shumën 93.398.395 lekë pa tvsh, e cila (citojmë): është realizuar i vetëm nga operatori ekonomik Rej shpk.
- Kontratë nr.2128/ 13 datë 03.05.2016 lidhur midis shoqërisë “’ITA Alba Lam” shpk dhe Bashkisë Tiranë, me objekt ”Pastrimi i pjesës Lindore – 2 të Qytetit të Tiranës”, me afat 365 ditë, me vlerë vjetore 178.718.946 lekë me tvsh,
    - Situacionet për periudhën Maj 2016- Maj 2017;
    - faturat tatimore të shitjes për periudhën Maj 2016 – Maj 2017, të panënshkruara nga bleresi
- Kontratë nr.12565/8 datë 12.12.2014 lidhur midis shoqërisë “TTA Alba Lam” shpk dhe Bashkisë Tiranë, me objekt ”Pastrimi i pjesës Lindore – 2, të qytetit të Tiranës”, me afat 365 ditë, me vlerë vjetore 231.166.357 lekë me tvsh;
    - Situacionet për periudhën Dhjetor 2014 – Dhjetor 2015

Open Procurement Albania

- faturat tatimore të shitjes për periudhën Dhjetor 2014 – Dhjetor 2015, të panënshkruara nga blerësi,

- Shtesë kontratë nr.10367/6, datë 22.10.2013 lidhur midis shoqërisë "TTA Alba Lam" shpk dhe Bashkisë Tiranë, me afat 365 ditë kalendarike, me vlerë 188.007.384 lekë me tvsh, me objekt "Pastrimi i pjesës lindore – 2 të qytetit Tiranë",
  - Faturat tatimore të shitjes Nëntor 2013 – Tetor 2014, të panënshkruara nga blerësi;
  - Situacionet Nëntor 2013 – Tetor 2014;
- Kontratë nr.5037/7 datë 22.02.2016 lidhur midis shoqërisë "TTA Alba Lam" shpk dhe Bashkisë Tiranë, me objekt "Pastrimi i pjesës Lindore – 2, të qytetit të Tiranës", me afat 90 ditë, me vlerë 55.754.312 lekë me tvsh;
  - Situacionet për periudhën Shkurt 2016 – Prill 2016
  - faturat tatimore të shitjes për periudhën Shkurt 2016 – Maj 2016, të panënshkruara nga blerësi,
- Shtesë kontratë nr.21163/7 datë 11.12.2015 lidhur midis shoqërisë "TTA Alba Lam" shpk dhe Bashkisë Tiranë, me objekt "Shtesë kontrate për objektin "Pastrimi i pjesës Lindore – 2, të qytetit të Tiranës", me afat 73 ditë, me vlerë 44.263.193 lekë me tvsh;
  - Situacionet për periudhën Dhjetor 2015 – Shkurt 2016
  - faturat tatimore të shitjes për periudhën Dhjetor 2015 - Shkurt 2016, të panënshkruara nga blerësi,
- Dokumenti "Pajisje me vërtetim për realizim të kontratave të pastrimit", për kontratat nr. Prot 10367/6 datë 22.10.2013; nr. Prot., 14312/6 datë 24.10.2014, nr. Prot., 15840/5 datë 27.11.2014; nr. Prot. 12565/8 datë 12.12.2014; nr. Prot. 21163/7 datë 11.12.2015; nr. Prot. 5043/7 datë 22.02.2016; nr. Prot. 2128/13 datë 03.05.2016, ku citohet vlera dhe afati përkatës i këtyre kontratave.

III.1.4. Operatori ekonomik ankimues pretendon:

1. *Lidhur me arsyen e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë " Rej" shpk & "T.T.Alba-Lam" shpk me pretendimin se Bashkimi i shoqerive Rej dhe T.T.A ALBALAM sh.p.k nuk permbush kriterin lidhur me sherbimet e ngjashme, te percaktuar ne dokumentat e tenderit,shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik, pika I,ku percaktohet shprehimisht: "Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktë Shërbime të meparshme te ngjashme në një vlerë jo me pak se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës të realizuar gjatë tre viteve të fundit . -Kur shër ngjashëm është realizuar me ente publike, duhet te paraqiten: 1. Kontrata 2. Situacionet për punimet e kryera 3. Vertetim nga Investitori ku të përcaktohet kohëzgjatja e shërbimit; vlera e shërbimit të realizuar si dhe permbushja me sukses e kontrates se sherbimit. -Kur sherbimi i ngjashem eshte realizuar me privat, duhet te paraqiten: 1.Faturat tatimore perkatese, te konfirmuara (ku te shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara) 2. Situacionet pë shërbimet e kryera " Konkretisht mangesite e konstatura jane si me poshte: 1) Shoqeria REj ka paraqitur 2 kontrata. I-Kontraten me Bashkine Pogradec, sa me Siper ka paraqitur –Kontrate-Situacione -Vertetim Kontrata e paraqitur eshte lidhur ne daten 16. 01.2015 ku pale jane Bashkia Pogradec dhe Bashki shoqerive "REJ sh.p.k dhe Shpresa sh.p.k" me afat 5 vjecar duke filluar nga data 16. 01.2015-15. 01.2020. Gjithashtu eshte lidhur edhe nje kontrate*

*shtese 31.12.2015 me kete bashkim shoqerish. Ne kontrate nuk ka asnje te dhene lidhur perqindjen dhe sherbimet konkrete qe do te kryeje sejcila nga shoqerite menyre qe te vleresohet nese shoqeria Raj sh.p.k ploteson vleren e sherbimeve te ngjashme. Vertetimi i leshuar nga Bashkia Pogradec me Nr 79/1 date 18.01.2018 nuk ka te percaktuar nese kontrata eshte permbushur me sukses ,pra nuk ka nje vleresim per cilesine e sherbimit te kryer nga kjo shoqeri. pe teper ka konfirmuar qe, ne kundershtim me sa eshte percaktuar ne kontraten baze dhe ne ate shtese, sherbimi eshte kryer vetem nga shoqeria REJ sh.p.k Situacioni i Janarit 2018 nuk eshte i firmosur dhe vulosur nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec. II. Kontrata me Komunen Udenisht Lidhur me sa me eshte paraqitur Kontratë -Situacione -Vertetim Kontrata e paraqitur eshte lidhur ne daten 30.04.2012 me afat 5 vjecar ku pale kane qene Komuna t Shoqeria REJ. Ne vertetim jepen te dhena per periudhen 30.04.2012-30.04.2015 dhe jane paraqitur situaeione vetem per periudhen Janar 2015-Prill 2017 situacioneve per kete periudhe eshte 5.443.193 lekë pa tvsh.*

*Situacionet e muajit korrik 2015, gusht 2015, shtator 2015 dhe dhjetor 2016 nuk jane te firma supervizori. Vertetimi i paraqitur nga Shoqeria T. T.A ALBALAM per realizimin e sherbimeve te ngjashme nuk permban informacion lidhur me realizimin me te sherbimit por vetem nje listim të kontratave te lidhura me Bashkine Tirane ne kundershtim me percaktimin e bërë ne dokumentat e tenderit ku jane pe elementet qe duhet te permbaje vertetimi te cilat jane : kohëzgjatja e shërbimit vlera e shërbimit të realizuar -si dhe permbushja me sukses e kontrate sherbimit.*

*Gjykojmë se pretendimi i mësipërm nuk është i bazuar në fakt dhe në ligj dhe si i tillë nuk qëndron.*

*1.1. Në shtojcën mbi modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit autoriteti juaj kontraktor ka parashikuar: "I. Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:*

*Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më pak se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës së realizuar gjatë tre viteve të fundit.*

*- kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me ente publike, duhet të paraqiten:*

*1. Kontratë*

*2. Situacionet për punimet e kryera*

*3. Vërtetim nga Investitori ku të përcaktohet kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar si dhe përmbushja me sukses e kontratës së shërbimit.*

*- Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten:*

*1. Faturat tatimore përkatëse, të konfirmuara (ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara)*

*2. Situacionet për shërbimet e kryera*

*1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, bashkimi i operatorëve ekonomikë ka dorëzuar:*

*- Kontratën e bashkëpunimit nr. 1153 rep., dhe nr. 449 kol në të cilën është parashikuar se përqindja e pjesëmarrjes e shoqërisë "Rej" sh.p.k. për të cilën ju ngrini pretendime në lidhje me disponueshmërinë e inxhinierit mekanik është vetëm 9.54%.*

*- Kontratë nr. 1, datë 30.04.2012 lidhur mes Komunës Udënisht dhe operatorit ekonomik "Rej" sh.p.k. shoqëruar me vërtetim nr. 349/1 datë 20.02.2018 me anë të së cilës pasqyrohet se është kryer shërbimi me sukses ndaj Komunës Udenisht. Nënvizojmë se pas*

*hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014 Komuna Udenisht i përket tashmë Bashkisë Pogradec dhe është kjo e fundit përgjegjëse për të drejtat dhe detyrimet e njësive territorial të marrë në administrim nga kjo e fundit. Ndaj pretendimi juaj nuk qëndron se nuk është dorëzuar asnjë vërtetim për kontratën e realizuar me Komunën Udenisht. Kjo kontratë është shoqëruar me Situacionet përkatëse dhe Faturat Tatimore të lëshuara dhe pranuara rregullisht nga ana e autoritetit kontraktor.*

*-Kontratë datë 16.01.2015 lidhur midis autoritetit kontraktor Bashkia Pogradec dhe bashkimi i operatorëve ekonomikë "Rej" shpk dhe "Shpresa" shpk, shoqëruar me situacionet përkatëse, faturat tatimore të lëshuam dhe pranuara rregullisht dhe me vërtetimin nr.79/1 datë 18.01.2018 lëshuar nga Bashkia Pogradec*

*-Kontratë nr.2128/ 13 datë 03.05.2016 lidhur midis shoqërisë "'ITA Alba Lam" shpk dhe Bashkisë Tiranë shoqëruar me fatura, situacion përkatës dhe vërtetim*

*-Kontratë nr.12565/8 datë 12.12.2014 lidhur midis shoqërisë "TTA Alba Lam" shpk dhe Bashkisë Tiranë shoqëruar me fatura, situacion përkatës dhe vërtetim*

*-Kontratë nr10367/6 datë 22.10.2013 lidhur midis shoqërisë "TTA Alba Lam" shpk dhe Bashkisë Tiranë shoqëruar me fatura, situacion përkatës dhe vërtetim*

*1.3. Në lidhje me pretendimin tuaj të parë se në dokumentcionin e dorëzuar për kontratën e lidhur me Komuna Udënisht nuk është shoqëruar me vërtetim pëkatës, theksojmë se pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.115/2014 Komuna Udenisht i përket tashmë Bashkisë Pogradec dhe është kjo e fundit përgjegjëse për të drejtat dhe detyrimet e njësive territorial të marrë në administrim nga kjo e fundit. Ndaj pretendimi juaj nuk qëndron se nuk është dorëzuar asnjë vërtetim për kontratën e realizuar me Komunën Udenisht. Ndaj është lësshuar vërtetimi nr. 349/1 datë 20.02.2018 me anë të së cilës pasqyrohet se është kryer shërbimi me sukses ndaj komunës Udenisht.*

*Në lidhje me pretendimin se në kontratë nuk përshkruhet saktë përqindja që zotëron shoqëria "Rej" shpk, nënvizojmë se ne në cilësinë e operatorit ekonomik pjesëmarrës nuk është në dëshirën apo vullnetin tonë mënyra e hartimit të kontratës, por është përegjësi direkte kjo bazuar në nenin 12 të ligjit për prokurimin publik e autoritetit kontraktor. Gjithashtu ne nuk mund të mbajmë përgjegjësi. mbi mënyrën e lëshimit të vërtetimeve nga ana e autoritetit kontraktor, megjithatë nenin 66 pika 2 të VKM 914/2014 ku parashikohet se "Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të si anëtarit/anëtarëve." Nëse autoriteti Juaj do të kishte paqartësi në lidhje me pëmibushjen e kriterit të sipërcituar atëherë mund të kishte kryer verifikime si pranë shoqerise tonë ashtu edhe pranë Bashkisë Pogradec. Ne si operatorë ekonomikë kemi dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dosjen e tenderit, pra kontratë shoqëruar me vërtetim me faturë dhe me situacionet përkatëse. Në asnjë pikë të DST apo të ligjit nuk parashikohet se në rast se kontrata është lidhur me bashkim operatorësh duhet të dorëzohet edhe kontrata e bashkëpunimit.*

*Në nenin 55 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar ku shprehimisht thuhet se Autoriteti kontra/(tor vlerëson dhe krahason ojizrtat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit. Sa*

*më sipër atutoriteti juaj po skualiiikon ofertën e shoqërisë tonë duke iu referuar kritereve të pa kërkuara. Fakti që në kontratë nuk pasqyrohet përqindja nuk është për faj të shoqërisë tonë por përgjegjësi e autoritetit kontraktor. Autoriteti Kontraktor për të provuar vlerën e shërbimit të ngjashëm të kryer nga REJ shpk duhet ti referohet Vërtetimit të lëshuar nga Autotiteti përkatës Bashkia Pogradec, nuk ka arsye të aludojë në lidh je me vërtetimin e lëshuar nga ky institucion. Për këtë cështjte është shprehur dhe KPP në Vendimin Nr.157/2017.*
*Si përfundim, shoqëria "Rej" shpk disponon 5 757 693 lekë pa tvsh si vlerë shërbimesh të kryera brenda afatit 3 vjeçar nga dita e dorëzimit të ofertave si kontratë e kryer me suskes me Komunën Udënisht dhe vlerë 95,689,411.00 lekë si vlerë shërbimesh të kyera gjatë 3 Vite teve të fundit me Bashkinë Pogradec në përputhje me nenin 74 pika 3 të VKM 914/2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Në lidhje me faktin se janë paraqitur vetëm situacione për periudhën janar 2015, sqarojmë se situacionet e tjera nuk kanë asnjë efekt për vlerësimin e ofertës, pasi janë jashtë afatit 3 vjeçar dhe në përputhje me parashikimet e nenit 28 pika 3 të VKM 914/2014. Informacioni se kontrata është kryer me sukses merret nga vërtetimi i lëshuar. Në lidhje me pretendimet se situacioni i një muaji nuk është i firmosur nga supervizori, nënvizojmë se në DST është kërkuar dorëzimi i situacioneve dhe jo ndonjë element specifik. Por akoma më tej, është dorëzuar fatura tatimore e pranuar nga autoriteti dhe pasqyruar në vërtetim, ku në rast se situacioni nuk do të ishte pranuar atëherë as fatura nuk do të ekzistonte e pranuar.*
*l.3.Në lidhje me pretendimin se vërtetimi i lëshuar nga bashkia Tiranë nuk është i vlefshëm për shoqërinë "TTA Alba Lam" shpk nëvizojmë se në dokumentet e procedures dhe veçanërisht DST standarde të Shërbimeve nuk ekziston ndonjë formë e posaçme për lëshimin e vërtetimit, ndaj si e tillë është në dorën e autoritetit kontraktor të lëshojë vërtetime dhe referenca sipas formatit të tyre. Konkretisht në vërtetimin nr.30144/1 prot datë 6.9.2017 të leshuar nga Bashkia Tiranë për anëtarin e bashkimit të operatorëve ekonomikë TTA Alba Lam shpk merret informacion mbi emërtimin e kontratës, vlerën e kontratës, kohëzgjatjen e kontratës ndërsa lënda është paisje me vërtetim për realizim kontrate, pra në rast se nuk do të ishte realizuar kontrata me sukses atëherë ky vërtetim nuk do të ishte lëshuar. Akoma më tej fakti që kontrata është realizuar me suskes vërtetohet edhe nga sltuacionet përkatëse dhe faturat tatimore të pranuara. Sa më sipër, ritheksojmë se BOE përmbush në përputhje me % e bashkëpunimit dëshminë e eksperiencave të ngjashme. Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.*
*Gjithashtu ne kuader te parimit te transparences dhe barazise ne trajtimin e kerkesave dhe detyrimeve ngarkuar oe ne nje procedure prokurimi parashikuar nga neni 2 i LPP-se kerkojme trajtim te njejte edhe me oe te kualifikuar. Vertetimi i te cilit leshuar nga Bashkia Tirane eshte ne forme dhe ne te dhenat qe percjell objektivisht i njejte me vertetimin tone.*
Sqarojmë se, në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, operatori ekonomik ankimues pretendon se: "*Për një shqyrtim të plotë të pretendimeve bashkëngjitur gjeni edhe Kontratën e Partneritetit nr. 760 rep, nr. 151/1 kol, datë 05.11.2014[...]".*
III.1.5. Autoriteti kontrator në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues argumenton se:

*I. Lidhur me arsyen e skualifikimit per kontratat e ngjashme:*

*KSHA konstatoi: Ne dokumentet e tenderit shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik, pika l, ndryshuar me shtojcen ne dokumentat e tenderit date I8.0l.2018,eshte parashikuar shprehimisht: "[...]*
*2. Ne kontraten e bashkepunimit te shqerive Rej sh.p.k dhe T.T.A ALBALAM sh.p.k,date 19.02.2018, ne piken 6 te saj eshte parashikuar se : "Firma Rej shpk do te kryeje 9. 5 4% te vlerave te zerave te punimeve te preventivit, "T. T.A ALBA LAM" sh.p.k do te kryeje 90. 46% te vlerave te zerave te punimeve te preventivit. "*
*3. Bazuar ne 74 pika 3 te VKM 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publiK" ku percaktohet se: "-Kërkesat ekonomi/te, financiare, profesionale dhe ata teknike duhet të përmbushen nga I gjithe bashkimi, në perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne pune sherbim apo furnizim te percaktuar ne aktmarreveshje", shoqeria Rej sh.p.k duhet te paraqese sherbime te ngjashme ne vleren 13.617.l65 lek pa tvsh.*

*KSHA arsyeton se: Vertetimi nr. 79/1, datë 18.01.2018, i lëshuar nga Bashkia Pogradec nuk permban te gjitha elementet e kerkuar ne kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit. Se pari nuk ka te percaktuar nese kontrata eshte permbushur me sukses dhe se dyti nuk ka te dhena lidhur me perqindjen e punimeve te kryera nga shoqeria Rej sh.p.k, se treti informacionet qe jepen ne vertetim nuk perputhem me kontraten ku nga njera ana paraqitet nje kontrate e lidhur me bashkimin e shoqerive Rej sh.p.k dhe Shpresa sh.p.k dhe nga ana tjeter paraqitet nje vertetim ku citohet se sherbimi eshte kryer vetem nga shoqeria Rej sh.p.k.*
*Akoma me tej ne rast se i referohemi te dhenave te paraqitura ne Vendimin e KPP Nr 157/2017, rezulton se vertetimi i paraqitur ne tenderin e Bashkise Vlore pavaresisht se eshte per te njejten kontrate te lidhur me Bashkine Pogradec, i permban te dhena te ndryshme krahasuar me vertetimin e paraqitur ne Bashkine Korce, lidhur me operatorin qe ka kryer sherbimin dhe vleren e kryer prej tij. Pra pretendimet e cituara me siper ne pikat a,b dhe c nuk qendrojne.*

*-Lidhur me situacionin e janarit 2018 te paraqitur nga shoqeria Rej sh.p.k,rezulton se ky situcaion nuk eshte i firmosur nga Autoriteti Koatraktor, konkretisht nga Kryetari i Bashkise (jo nga supervizori sic citohet nga ankuesi ) si rezultat nuk eshte I rregullt.*

*Lidhur me pretendimin se nuk eshte kerkuar qe situacioni te jete I firmosur, KSHA gjykon se situacioni dhe cdo dokument tjeter duhet te kete formen e kerkuar ligjore dhe nenshkrimin nga personat pergjegjes. Ne rast se ndjekim logjiken e ankuesit edhe ne rast se paraqitet nje kontrate e pa firmosur dhe vulosur nga personat pergjegjes eshte e rregullt sepse ne kriteret nuk eshte kerkuar qe kontrata te jete e firmosur. Per sa me siper KSHA arrin ne perfundimin se situacioni nuk eshte i rregullt per sa kohe nuk eshte i nenshkruar nga personat pergjegjes. Sa me siper pretendimi i ankuesit nuk qendron.*

*Per dokumentacionin e paraqitur per sherbimet e kontraktuara nga Komuna Udenisht, KSHA arsyeton se:*
*Pretendimi i cituar e piken "a" nuk qendron pasi Komisioni i Vleresimit te Ofertave nuk eshte shprehur se mungon vertetimi nga komuna Udenisht. -Ankuesi nuk ka paraqitur kundershtime*

*lidhur me mungesen e firmes te supervizorit ne situacionet e Situacionet e muajit korrik 2015, gusht 2015, shtator 2015 dhe dhjetor 2016. KSHIA gjykon se situacionet dhe cdo dokument tjeter duhet te kete formen e kerkuar ligjore dhe nenshkrimin nga personat pergjegjes,si rezultat situacionet e muajit korrik 2015, gusht 2015, shtator 2015 dhe dhjetor 2016 nuk jane te rregullt. -Pretendimi i cituar ne piken" b" nuk qendron pasi Komisioni i Vleresimit te Ofertave nuk eshte shprehur qe jane paraqitur situacione vetem per periudhen janar 2015 por eshte shprehur se jane paraqitur situacioue vetem per periudhen Janar 2015-Prill 2017.*

*Per plotesimin e kriterit te sherbimeve te ngjashme nga shoqeria TTA ALBA LAM sh.p.k, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka arritur ne perfundimin se : "Vertetimi i paraqitur nga Shoqeria TTA ALBALAM per realizimin e sherbimeve te ngjashme nuk permban informacion lidhur me realizimin me sukses te sherbimit por vetem nje listim te kontratave te lidhura me Bashkine Tirane ne kundershtim me percaktimin e bere ne dokumentat e tenderit ku jane percaktuar elementet qe duhet te permbaje vertetimi te eilatjane : ~ kohëzgjatja e shërbimit ~ vlera e shërbimit të realizuar \si dhe permbushja me sukses e kontrates se sherbimit:*

*KSHA arsyeton se:*
*-Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar shprehimisht: "Vertetim nga Investitori ku të përcaktohet kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar si dhe permbushin me sukses e kontrates se sherbimit. " -Në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Neni 63, "Të drejtat e personit të interesuar", pika l.l pnmshikohet se: "Në rastin e ankesave për dokumentat e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit i njoftimit të kontratës në faqen e lntemetit të Agjencisë së Prokurimit Publik".[...]. KSHA sqaron se në legjislacionin për prokurimin publik është parashikuar qartësisht e drejta e operatorëve ekonomikë për procesin e ankimlmit në lidhje me të gjitha fazat apo hapat që përfshijnë një procedurë prokurimi dhe konkretisht e drejta për t'u ankimuar që në fazën e parë për kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si edhe e drejta për t'u ankimuar në fazat e tjera në vazhdim që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave deri në lidhjen e kontratës. Për rrjedhojë, nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me këtë kriter, atëherë ky i fundit mund të kërkonte ndryshimin e tij mbështetur në nenin 63, pika 1.1 të ligjit të sipërcituar.*

*Lidhur me pretendimin ankuesit se nuk ka trajtim te njejte me operatorin ekonomik te kualifikuar, KSHA konstatoi se ky pretendim nuk qendron sepse se pari operatori ekonomik i kualifikuar nuk ka paraqitur vetem kontrata te realizuara me Bashkine Tirane dhes se dyti ne njerin nga vertetimet e leshuara nga Bashkia Tirane eshte cituar shprehimisht se "Gjate realizimit te ketyre kontrataveshoqeria Korsel,ka permbushin me korrektesi te gjitha detyrimet kontraktuale ndaj Autoritetit Kontraktor Bashkia Tirane.*

III.1.6. Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive të mësipërme rezulton se ka mangësi në plotësimin e kriterit për kontratat e ngjashme, pasi operatori ekonomik "Rej" sh.p.k. në përputhje me pjesën e tij të përqindjes së marrë përsipër nuk ka paraqitur kontratë

të ngjashme në vlerën që i përket sipas kësaj përqindje. Ashtu siç edhe autoriteti kontraktor sqaron, operatori ekonomik ”Rej” sh.p.k. për të vërtetuar se ka kryer eksperienca të mëparshme të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, ka paraqitur disa kontrata, ku njëra është lidhur me Bashkinë Pogradec ndërmjet bashkimit të operatorëve ekonomikë ”Rej” sh.p.k. & ”Shpresa” sh.p.k., në të cilën nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me përqindjen që ka secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ”Rej” sh.p.k. & ”Shpresa” sh.p.k., në mënyrë që të përllogaritet pjesa e shërbimeve të kryera nga shoqëria ”Rej” sh.p.k. e që rrjedhimisht të verifikohet nëse e përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.
Kontrata e lidhur me Bashkinë Pogradec si edhe shtesa e kontratës me këtë autoritet, ka të përcaktuar se si operator ekonomik është bashkimi i shoqërive ”Rej” sh.p.k. dhe ”Shpresa” sh.p.k., dhe si e tillë duhet që te vërtetohet sa është pjesa e përqindjes së marrë përsipër prej secilit prej këtyre anëtarëve, ndërkohë që edhe në vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Pogradec nuk jepet asnjë e dhënë në lidhje me këtë përqindje, por thuhet se kjo kontratë është realizuar vetëm nga shoqëria ”Rej” sh.p.k. edhe pse në kontratat e lidhura është përcaktuar qartë që kjo kontratë lidhet me bashkimin e operatorëve ekonomikë dhe jo vetëm me shoqërinë ”Rej” sh.p.k. Gjithashtu, edhe vërtetimi ka mangësi, pasi nuk përmban në të të gjitha të dhënat e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor, të tilla si përmbushja me sukses e kontratës, element ky i kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Sa më sipër, kjo kontratë e paraqitur nuk mund të merret në konsideratë për shkak të mangësive që ajo ka, konkretisht mosparaqitja e përqindjes që ka secili operator ekonomik në këtë bashkim operatorësh, me qëllim që të bëhet përllogaritja e vlerës së kontratës së ngjashme të mëparshme të operatorit ekonomik ”Rej” sh.p.k., në përputhje me përqindjen e bashkëpunimit të marrë përsipër për realizimin e kësaj kontrate, referuar, kontratës së bashkëpunimit me operatorin ekonomik ”TTA Alba Lam” sh.p.k.
Edhe në kontratën tjetër të paraqitur nga operatori ekonomik ”Rej” sh.p.k., të realizuar me Komunën Udënisht, ka disa mangësi, sepse, disa nga situacionet e paraqitura për këtë kontratë, nuk janë sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, pasi nuk kanë të gjitha nënshkrimet e duhura nga palët e caktuara për ndjekjen e saj. Në kushtet kur meret në konsideratë vetëm kontrata me Komunën Udenisht, e cila nga ana saj pavarësisht problemeve dhe mangësive që ka si më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se sërish operatori ekonomik ”Rej” sh.p.k. nuk arrin të përmbushë kriterin për kontrata të ngjashme, pasi nuk plotëson vlerën që i korrespondon sipas përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.
Rrjedhimisht, referuar përqindjes së përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit të lidhur ndërmjet operatorëve ekonomikë ”Rej” sh.p.k. & ”TTA AlbaLam” sh.p.k., bazuar në dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, operatori ekonomik ”Rej” sh.p.k. nuk përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit, pasi nuk plotëson vlerën për kontrata të ngjashme.
Sa më sipër dokumentacioni i paraqitur në lidhje me përmbushjen e kriterit për kontratat e ngjashme nuk është në përputhje me kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit si edhe me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.
III.1.7. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të*

*tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi".* Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *"Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokure përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi…",* ndërsa në pikën 3 parashikohet: "*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*".

III.1.8. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*." Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...".*

III.1.9. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kritereve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Rej" sh.p.k. & "TTA AlbaLam" sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi operatori ekonomik "Rej" sh.p.k. nuk e plotëson kërkesën për kontratat e ngjashme sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokument për të provuar pjesën e përqindjes së secilit prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë "Rej" sh.p.k. & "Shpresa" sh.p.k. për kontratën e paraqitur si eksperiencë të ngjashme të mëparshme të lidhur me Bashkinë Pogradec, fakt ky i pranuar edhe nga vetë operatori ekonomik ankimues, i cili sqaron se e ka paraqitur

Open Procurement Albania

bashkëngjitur ankesës së depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik një dokument të tillë. Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i RSH", barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, operatori ekonomik ankimues, vetëm në ankesën e paraqitur pranë këtij të fundit, ka depozituar edhe dokumentacion shtesë, përvecc atij të depozituar në sistemin e prokurimeve elektronike, dhe konkretisht Kontratë Partneriteti të lidhur ndërmjet shoqërisë "Rej" sh.p.k. dhe "Shpresa" sh.p.k. për kontratën e paraqitur si eksperiencë të mëparshme të lidhur ndërmjet këtij bashkimi operatorësh ekonomikë dhe Bashkisë Pogradec.

Sa më sipër, sqarojmë se, dokumentacione shtesë, të cilat ndikojnë në vlerësimin e një operatori ekonomik në një procedurë prokurimi, të cilat rrjedhimisht ccojnë në ndërhyrjen në ofertë, nuk mund të konsiderohen si të vlefshme, pasi nuk mund të lejohet apo pranohet asnjë dokumentacion pas hapjes së ofertave dhe që nuk është depozituar në sistemin e prokurimeve elektronike përpara datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit.

III.1.10. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se, autoriteti kontraktor nuk ka qenë në kushtet e nenit 53, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"* i ndryshuar. Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Nuk mund të lejohet paraqitja e asnjë dokumenti tjetër pas mbarimit të afatit për hapjen e ofertave, pasi një gjë e tillë do të konsiderohej ndërhyrje në ofertë.

Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e ankimuesit në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

III.1.12. Akoma më tej, referuar arsyes së skualifikimit, nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se edhe nga ana e operatorit ekonomik "TTA Alba – Lam" sh.p.k. si anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë "Rej" sh.p.k. & "TTA Alba – Lam" sh.p.k., ka mangësi, pasi vërtetimi i realizimit të paraqitur nga Bashkia Tiranë për kontratat e mëparshme të ngjashme të lidhura ndërmjet kësaj të fundit dhe këtij operatori ekonomik, nuk përmban në të, të gjitha të dhënat e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor, të tilla si përmbushja me sukses e kontratës, element ky i kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Në këtë vërtetim konstatohen vetëm kontratat e lidhura, objekti i tyre, vlera dhe afati, dhe nuk citohet asgjë në lidhje me mënyrën e realizimit të tyre, element ky i rëndësishëm në lidhje me eksperiencat e mëparshme, si edhe për më tepër i kërkuar dhe përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor.

Open Procurement Albania

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kerkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedurial të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar parashikohet se *"Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni"*.
Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me intepretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kritereve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedurial të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se *"[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]"*.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se arsyeja e skualifikimit : *Bashkimi i shoqerive Rej sh.p.k dhe T.T.A ALBALAM sh.p.k nuk permbush kriterin e percaktuar ne dokumentat e tenderit,shtojca7,kriteret e vecanta te kualifikimit,kapaciteti teknik,pika pika XII ,ku percaktohet shprehimisht: "Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme: 1. 2 ( dy ) makina teknologjike për fshirjen e rrugëve ( fshese mekanike ), te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qëndrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës. 2. Borepastruese cope 2 (dy), te jene te pajisura me mekanizmin e hedhjes se kripes. 3. Makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor per mbledhjen dhe evadimin e mbeturinave, me kapacitet mbajtes jo me pak se 10 ton, cope 4 ( kater ) 4. Makina kompatator per heqjen e mbeturinave ne lagjet pa kontenier,jo me shume se 3,5 ton,cope 3 ( tre ) . 5. Makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor per mbledhjen dhe evadimin e mbeturinave, me kapacitet*

*mbajtes deri ne 7 ton, cope 3 ( tre ) . 6. Makina për larjen e rrugëve, (mjet teknollogjike) të pajisur me pompë për larjen e rrugëve me presion, pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesën anësore të tij, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10.000 litra ujë, jo më pak se 1 (nje) copë; 7. Makina për lagien e rrugëve, (mjet teknollogjike) të pajisura me pompë për lagien e rrugeve,me kapacitet mbajtes jo më pak se 10.000 litra ujë, jo më pak se 1 (nje) copë; 8. Fadrome me goma per heqjen e inerteve me kapacitet te koves jo me pak se 1 m3 ,cope 1 ( nje ) 9. Traktor per shtytjen dhe ngjeshjen e mbeturinave ne fushe cope 1 ( nje ) . 10. Makine transporti per mbetjet e riciklueshme(leter,plastike,qelq,alumin)me shenja dalluese,1 (nje cope) 11. Kamioncine per evadimin e mbetjeve inerte,1 (nje)cope Dokumentacioni qe duhet te dorezohet per mjetet e mesiperme : -Ne rast se jane ne pronesi duhet te paraqiten, certifikata e pronesise , leja e qarkullimit ,certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit. -Kur jane me qera te paraqiten: kontrata e qerase vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit ,certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit. - Ne rast se mjetet nuk jane ne pronesi apo me qera mund te paraqiten Akt Marrëveshje porosie/Kontratë e Porosie/kontrate leasing/ ose marreveshje per shitjen me kusht te mjeteve Kontratat dhe marreveshjet e sipercituara duhet te jene lidhur perpara noterit dhe duhet të përmbajnë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës /marreveshjes si dhe afatin për ekzekutimin e saj. -Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve."*

*Konkretisht mangesite e konstatura jane si me poshte:*

*Se pari: Ne Kontraten e bashkepunimit te shqerive Rej sh.p.k dhe T.T.A ALBALAM sh.p.k ,Pika 13 e kesaj kontrate ku percaktohet se " Kapaciteti ekonomik dhe teknik (mjetet dhe stafi teknik etj)I shoqerise Rej sh.p.k,do te jete ne dispozicion te bashkimit te operatoreve "T.T.A .Alba Lam"sh.p.k dhe "Rej" sh.p.k ne rast se ky bashkim operatoresh shpallet fitues .Per kete arsye nuk eshte pare e arsyeshme te behen kontrate qeraje per mjetet qe do te perdoren ne kete kontrate. Gjithashtu eshte e vlefshme edhe e anasjellta." eshte ne kundershtim me percaktimin e bere ne nenin 74 pika 3 te VKM 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publiK" ku percatohet si me poshte: -Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje. Per sa me siper duke qene se ne aktmarrevshjen noteriale te lidhur per furnizimin me makineri nuk eshte bere ndarja e tyre por marreveshja eshte bere nga bashkimi i shoqerive,nuk mund te gjykohet nese sejcili nga anetaret e bashkimit e permbush kriterin e mjeteve ne perputhje me perqindjen qe ka marre persiper ne marreveshjen e bashkepunimit. Se dyti: Ne aktmarreveshjen noteriale te lidhur per furnizimin me makineri eshte percaktuar nder te tjera mjeti "Makine teknologjike transportuese jo me pak se 7 ton"sasia 4 cope" cka bie ne kundershtim me kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit ku kerkohet : "Makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor per mbledhjen dhe evadimin e mbeturinave, me kapacitet mbajtes deri ne 7 ton,*

Open Procurement Albania

*cope 3 ( tre ) . Pra kapaciteti i mjeteve te kerkuara eshte deri ne 7 ton ,kapaciteti i mjeteve te ofruara sipas marreveshjes eshte jo me pak se 7 ton. "*
*Se treti : Ne kriteret e vendosura ne dokumentat e tenderit eshte percaktuar shprehimisht se : " Ne rast se mjetet nuk jane ne pronesi apo me qera mund te paraqiten Akt Marrëveshje porosie/Kontratë e Porosie/kontrate leasing/ ose marreveshje per shitjen me kusht te mjeteve " Kontratat dhe marreveshjet e sipercituara duhet te jene lidhur perpara noterit dhe duhet të përmbajnë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës /marreveshjes si dhe afatin për ekzekutimin e saj." Ne aktmarreveshjen e dorezuar nuk ka te dhena teknike per mjetet por eshte percaktuar ne piken 4.6 te saj se "Bashkengjitur kesaj aktmarreveshje jane kataloget me te dhenat e sakta teknike dhe tipin e mjeteve dhe automjeteve" . Lidhur me sa me siper,per sa kohe qe kataloget teknike jane pjese e aktmarreveshjes, duhet te ishin firmosur nga te tre palet e aktmarreveshjes dhe te ishin lidhur me vule lidhese nga noteri. Per sa kohe ato jane te firmosura vetem nga njera pale konkretisht shoqeria Erka BMC 2007 athere arrijme ne perfundimin se nuk ka nje konfirmim nga te gjitha palet e marreveshjes lidhur me mjetet konkrete sipas te dhenave teknike qe jane kerkuar,si nuk mund te merren ne shqyrtim kataloget me te dhenat e mjeteve te firmosur ne menyre te njeanshme.*
*Se katerti: Lidhur me mjetet e deklaruara me qera nga Shoqeria REJ sh.p.k: -Kontrata e qerase per fadromen me goma e lidhur ndermjet shoqerise "REJ" dhe "Flamur Hoxhaj" nuk eshte vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi sic kerkohet ne dokumentat e tenderit. Eshte percaktuar qe afati I kontrates te qerase do te jete 5 vjet nga data e kontrates. Data e kontrates te qerase eshte 01.02.2018. Pra perfundon ne 01.02.2023, rrjedhimisht para perfundimit te kontrates qe do te lidhet per kete objekt. GJithashtu kontrata e qerase nuk eshte lidhur para noterit. -Kontrata e qerase per kamioncinen e lidhur ndermjet shoqerise "REJ" dhe Z.Engjell Suli nuk eshte vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi sic kerkohet ne dokumentat e tenderit. Eshte percaktuar qe afati i kontrates te qerase do te jete 5 vjet nga data e kontrates. Data e kontrates te qerase eshte 31.01.2018. Pra perfundon 31.01.2023,rrjedhimisht para perfundimit te kontrates qe do te lidhet per kete objekt. Gjithashtu kontrata e qerase nuk eshte lidhur para noterit. Gjithashtu nisur nga sherbimet konkrete qe ka marre persiper te kryeje shoqeria Rej konkretisht: "Pastrim rrugesh nga Debora+kriposje" "Mbledhje transport mbeturinash fshati", duhej qe shoqeria Rej sh.p.k te disiponte te pakten dy borepastruese dhe tre makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor per mbledhjen dhe evadimin e mbeturinave, me kapacitet mbajtes deri ne 7 ton, per trasportin e mbeturinave te fshatit,sic eshte percaktuar ne specifikimet teknike,* nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7 Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes, pika 2.2. Kapaciteti teknik, pika XII, pas modifikimit të publikuar në Shtojcën përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri: "*Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve**, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:*

1. *2 ( dy ) makina teknologjike për fshirjen e rrugëve ( fshese mekanike ), te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qëndrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës.*
2. *Borepastruese cope 2 ( dy ), te jene te pajisura me mekanizmin e hedhjes se kripes.*
3. *Makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor per mbledhjen dhe evadimin e mbeturinave, me kapacitet mbajtes jo me pak se 10 ton, **cope 4 ( kater )***
4. *Makina kompatator per heqjen e mbeturinave ne lagjet pa kontenier,jo me shume se **3,5 ton,cope 3 ( tre** ) .*
5. *Makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor per mbledhjen dhe evadimin e mbeturinave, me kapacitet mbajtes deri ne 7 ton, **cope 3 ( tre )** .*
6. *Makina për larjen e rrugëve, (mjet teknollogjike) të pajisur me pompë për larjen e rrugëve me presion, pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesën anësore të tij, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10.000 litra ujë, jo më pak se **1 (nje) copë;***
7. *Makina për lagien e rrugëve, (mjet teknollogjike) të pajisura me pompë për lagien e rrugeve,me kapacitet mbajtes jo më pak se 10.000 litra ujë, jo më pak se **1 (nje) copë;***
8. *Fadrome me goma per heqjen e inerteve me kapacitet te koves jo me pak se 1 m3 ,**cope 1 (nje**)*
9. *Traktor per shtytjen dhe ngjeshjen e mbeturinave ne fushe **cope 1 ( nje ) .***
10. *Makine transporti per mbetjet e riciklueshme(leter,plastike,qelq,alumin)me shenja dalluese,**1 (nje cope)***
11. *Kamioncine per evadimin e mbetjeve inerte,**1 (nje)cope***

*<u>Dokumentacioni qe duhet te dorezohet per mjetet e mesiperme :</u>*

*-Ne rast se jane ne pronesi duhet te paraqiten, certifikata e pronesise , leja e qarkullimit ,certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit.*

*-Kur jane me qera te paraqiten: kontrata e qerase vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit ,certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit.*

*- Ne rast se mjetet nuk jane ne pronesi apo me qera mund te paraqiten Akt Marrëveshje porosie/Kontratë e Porosie/kontrate leasing/ ose marreveshje per shitjen me kusht te mjeteve Kontratat dhe marreveshjet e sipercituara duhet te jene lidhur perpara noterit dhe duhet të përmbajnë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës /marreveshjes si dhe afatin për ekzekutimin e saj.*

*-Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

*Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve.*

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Kontratë Bashkëpunimi, ndërmjet shoqërisë “Rej” sh.p.k. dhe shoqërisë “T.T.A. Alba Lam” sh.p.k., nga ku shoqëria “Rej” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 9.54% të vlerave të zërave të punimeve të preventivit dhe konkretisht zërat:

Pastrim rrugësh nga dëbora + kriposje;

Mbledhje dhe transport mbeturinash fshati;

Larje e kontenierëve + dizifenktim;

ndërsa shoqëria ”T.T.A Alba-Lam” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 90.46% të vlerave të zërave të punimeve të preventivit dhe konkretisht zërat:
shërbimi i pastrimit natën;
mirëmbajtja e rrugëve ditën;
fshirje e rrugëve me fshesë mekanike;
mbledhje dhe transport mbeturinash qyteti;
lagie e rrugëve;
larje speciale e rrugëve;
depozitim inertesh dhe roje e venddepozitimit të vjetër.
Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Rej” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.
III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

- Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve, nga operatori ekonomik ”Rej” sh.p.k. ku evidentohet një listë e mjeteve të porosituara, listë e mjeteve me qera, listë e mjeteve në pronësi;
- Akt marrëveshje noteriale e lidhur në datën 14.02.2018, ndërmjet shoqërive ”Rej” sh.p.k., ”TTA Alba Lam” sh.p.k., ”Erka BMC 2007” sh.p.k. si distributor zyrtar për kompanitë Tatco, Ford, Cururova, Isuzu, Hyundai, Karsan etj, me qëllim sigurimin e plotë të të gjitha automjeteve dhe kamionëve dhe të gjitha llojet e makinerive teknologjike, kamionëve të mbeturinave dhe të gjitha pajisjet e nevojshme për ofrimin e shërbimit ”Pastrimi, evadimi i mbetjeve urbane në Bashkinë e Korçës (Shërbimi i pastrimit) të Bashkisë së Korçës, ku në pikën 4.3 të këtij akti është përcaktuar lista/tipi i automjeteve dhe kamionëve ku është përcaktuar si më poshtë:

| Lloji | Kapaciteti | Sasia |
|---|---|---|
| Fshesë mekanike për fshirjen e rrugëve | ------------------- | 4 copë |
| Borëpastruese | ------------------- | 3 copë |
| Makinë teknologjike transportuese | Jo më pak se 10 ton | 5 copë |
| Makinë kompatator | Jo më shumë se 3.5 ton | 3 copë |
| Makinë teknologjike transportuese | Jo më pak se 7 ton | 4 copë |
| Makinë për larjen e rrugëve | Jo më pak se 10.000 litra | 1 copë |
| Makinë për larjen e rrugëve | Jo më pak se 10.000 litra | 2 copë |
| Fadromë me goma | Jo më pak se 1 m3 | 1 copë |
| Traktor për shtytjen e mbeturinave | | 1 copë |
| Makinë transporti për mbetjet e riciklueshme | | 1 copë |
| Kamioncinë | | 1 copë |

Open Procurement Albania

Ndërsa në pikën 4.6. të këtij akti është përcaktuar: ”*Bashkëngjitur kësaj aktmarrëveshje janë katalogët me të dhënat e sakta teknike dhe tipin e mjeteve dhe automjeteve*”.

- Dokumenti për të dhënat e subjektit për shoqërinë Erka BMC 2007
- Katalogë të mjeteve, të nënshkruar nga shoqëria Erka BMC 2007
- Deklaratë për verifikimin e mjeteve;
- Kontratë qeraje ndërjmet shoqërisë ”Rej” sh.p.k. në cilësinë e qeramarrësit dhe qeradhënësit Z. F.H. për mjetin Fadromë me goma për heqjen e interteve me kapacitet të kovës me shumë se 1m3, me afat 5 vjeçar nga data e lidhjes së kontratës në rast se shoqëria ”Rej” sh.p.k. do të shpallet fitues në tenderin që zhvillon Bashkia Korçë; shoqëruar me policë sigurimi të mjetit, leje qarkullimi, taksa vjetore, çertifikatë pronësie, çertifikatë e kontrollit teknik, çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet,
- Fletë zhdoganimi për mjetin gërmues me rrotullim të superstrukturës, foto të mjetit,
- Fletë zhdoganimi për mjetin fadromë,
- Kontratë qeraje ndërmjet shoqërisë ”Rej” sh.p.k. në cilësinë e qeramarrësit dhe z. E.S si qeradhënës për mjetin Kamionçinë për evadimin e mbetjeve inerte, me afat 5 vjeçar nga data e lidhjes së kontratës në rast se Rej sh.p.k. do të shpallet fitues në tenderin që zhvillohet nga Bashkia Korçë, shoqëruar me leje qarkullimi, çertifikatë pronësie të mjetit, policë sigurimi, çertifikatë e kontrollit teknik, foto.

III.2.4. Operatori ekonomik ankimues pretendon: *5.1. Në lidhje me pretendimin e parë se: Konkretisht mangesite e konstatura jane si me poshte: Se pari: Ne Kontraten e bashkepunimit te shqerive Rej sh.p.k dhe TTA ALBALAM sh.p.k ,Pika 13 e kesaj kontrate ku percaktohet se " Kapaciteti ekonomik dhe teknik (mjetet dhe stafi teknik etj) i shoqerise Rej sh.p.k, do te jete dispozicion te bashkimit te operatoreve “T T A Alba Lam "sh p k dhe "Rej" sh p k ne rast se ky bashkim operatoresh shpallet fitues Per kete arsye nuk eshte pare e arsyeshme te behen kontrate qeraja per mjetet qe do te perdoren ne kete kontrate. Gjithashtu eshte e vlefshme edhe e anasjellta. " eshte ne kundershtim percaktimin e bere ne nenin 74 pika 3 te VKM 914 date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publiK" ku percatohet si me poshte: -Secili pr anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ata teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shër furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje. Per sa me siper duke qene se ne aktmarrevshjen noteriale te lidhur perfurnizimin me makineri nuk eshte be e tyre por marreveshja eshte bere nga bashkimi i shoqerive nuk mund te gjykohet nese sejcili nga anetaret e bashkimit e permbush kriterin " Gjykojmë se nuk është i bazuar në fakt dhe në ligj dhe si i tillë nuk qëndron.*
*5.2. Referuar arsyeve të skualifikimit, në asnjë rast Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka argumentuar se bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk përmbush kapacitetin teknik në drejtim të disponueshmërisë së makinerive në përputhje me kërkesat pjesë e dokumenteve të tenderit dhe nenit 74 pika 3 të VKM 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, por ka ngritur pretendime apriori dhe deduksione nisur nga premisa jo të vërteta se përsa kohë që në kontratën e bashkëpunimit është deklaruar se “ Kapaciteti ekonomik dhe teknik ( mjetet dhe stafi teknik) i shoqërisë “Rej " shpk do te jetë në dispozicion të shoqërisë "TTA Alba*

*Lam" shpk & Rej shpk në rast se ky bashkim shpallet fitues. Për këtë arsye nuk është parë e arsyeshme të bëhet kontratë qeraje për mjetet që do të përdoren në këtë kontratë.*
*Gjithashtu është e vlefshme edhe anasjellta. " Në lidhje me pretendimin & sipërcituar, gjejmë me vend të sqarojmë se kontrat e bashkëpunimit e lidhur mes palëve për pjesëmarrja në një procedurë prokurimi publik, bazohet jo vetëm në ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" të ndryshuar, por njëkohësisht edhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë. Me anë të krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit publik, njëherazi shoqëritë kanë krijuar edhe një shoqëri të thjeshtë, në kuptim të nenit 1074 të Kodit Civil ku parashikohet se "Shoqëria është një kontratë me të cilën dy apo më shumë persona merren vesh për të ushtruar një aktivitet ekonomik, me qëllim që të ndajnë litimet që rrjedhin prej tij. Personi anëtar i shoqërisë duhet të vërë në dispozicion të këtij aktiviteti para, sende apo shërbime." Në lexim gjuhësor dhe llogjik të pikës l3 të kontratës së bashkëpunimit të lidhur mes palëve, lehtësisht konstatohet se kjo e fundit nuk lidhet me momentin e vlerësimit dhe të dorëzimit të ofertave, por me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin pas lidhjes së kontratës mes shoqërive dhe mes shoqërive dhe autoritetit konti-aktor. Gjithashtu, kjo është një klauzolë me kusht pasi shprehet se në rast se lgy bashkim shpallet fitues, pra qartësisht vihet re se parashikimi i mësipërm nuk lidhet dhe nuk ka se si, me momentin e dorëzimit të ofertave dhe vlerësimit të tyre nga ana e autoritetit kontraktor por me momentin pas lidhjes së kontratës. Akoma më tej, deklarimi i mësipërm nuk cënon asnjë parashikim të nenit 74, apo edhe 76 të VKM 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar në lidhje me zbatimin e kontratës, por deklaron, pra palët marrin angazhim se në rast të shpalljes fitues vendosin kapacitetet e tyre teknike në mënyrë të përbashkët "Rej" shpk dhe "ITA Alba Lam" shpk dhe vice versa.*
*Gjithashtu dhe Komisioni i Prokurimit Publik në rastet ku ka patur paqartësi në kontratën e bashkëpunimit ka mbajtur një qëndrim të drejtë duke detyruar autoritetit kontraktor të shqyrtojë në tërësi dokumentacionin e dorëzuar mes palëve dhe mënyrën e pëmihushjes së secilit kriter dhe jo një vlerësim sipërfaqësor duke shmangur thelbin. Konkretisht në vendimin KPP 583/2017 Komisoni është shprehur se " 111.5.6. Referuar dokumentacionit të administruar, legjislacionit nëjirqi për pro/(urimin publik, si dhe pretendimet e palës ankimuese, Komisioni i Prokurimit Publik thekson se në pikën 1 dhe 3 të nenit 74 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave për prokurimin publik", indiyshuar; parashikohet se "Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. "3.Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo ftu-nizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. ".*
*Bazuar në interpretimin literal të neneve të sipërcituar, KPP gjykon se operatorët ekonomik të cilët vendosin të konkurojnë të bashkuar në një procedurë prokurimi, duhet ta zyrtarizojnë këtë bashkim nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, në të cilën ka detyrimin të përcakotjë pjesën e shërbimit, punës ose jurnizimit, që do të layejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, ndërsa kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga igjithë bashkimi, në*

*përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuar në këtë kontratë. Në rastin konkret, detyrimi i vetëm ligjor që duhet zbatuar në mënyrë që kjo kontratë bashkëpunimi të konsiderohet e vlefshme konsiston në deklarimin në përqinaje të punëve si dhe i zërave konkret të preventivit të punimeve që secili operator ekonomik merr përsipër të kryej. Ndërsa në lidhje me përmbushjen e kërkesave ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike, nuk është e detyrueshme që të deklarohet përqindja e kontributit, pasi bazuar në nenet e sipërcituara, ato përllogariten në mënyrë përpjestimore me përqindjen e deklaruar për punët që do të kryej gjithsecili.*

*Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përsa kohë kontrata e bashkëpunimit e dorëzuar elektronikisht nga Operatori ekonomik ankimues plotëson kushtet formale të cilat janë: lidhja përpara noterit; deklarimi i përqindjes së pjesëmarrjes në punë; nënshkrimi i rregullt i palëve etj., nuk mund të konsiderohet e parregullt dhe si pasojë të përbëjë shkak për skualifikimin e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë, pasi deklarimi se 45.8% e fuqisë punëtore, pajisjeve, kapacitetit financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria "SIRETA 2F" sh.p.k, ndërsa 54.2% e fuqisë punëtore, pajisjeve, kapacitetit financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria "ARTYKA II" sh.p.k., konsiderohet një deklarim shtesë jo i domosdoshëm dhe si i tillë nuk duhet të merret në konsideratë, qoftë ky deklarim i saktë apo jo. Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit "SIRETA 2F" sh.p.k & "ARTYKA II "sh.p.k. qëndron. Në mënyrë të qartë bashkimi ynë i operatorëve ekonomikë ka deklaruar përqindjen e bashkëpunimit-,të marrë përsipër si edhe mënyrën e plotësimit të saj. Plotësojmë të gjithë kapacitetin teknik në përputhje me pëqindjen e bashkëpunimit të deklaruar. Sa më sipër pretendimi juaj në lidhje me këtë pikë nuk qëndron.*

*5.3. Në lidhje me pretendimin e dytë se: Se dyti : Ne aktmarreveshjen noteriale te lidhur per furnizimin me maki eshte percaktuar nder te tjera mjeti ""Ma/tine teknologjike transportuese jo me pak se 7 ton"sasia 4 cope " cka bie ne kundershtim me kriterin e vendosur n dokumentat e tenderit ku kerkohet : "Makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor per mbledhjen dhe evadlmin e mbeturinave, me kapacitet mb deri ne 7 ton, cope 3 ( tre ) . Pra kapaciteti i mjeteve te kerkuara eshte deri ne 7 ton ,kapaciteti i mjeteve te ofruara sipas marreveshjes eshte jo me pak se" vlerësojmë se pretendimi nuk është i bazuar në ligj dhe si i tillë nuk qëndron. Gjykojmë se nuk është i bazuar në fakt dhe në ligj dhe sii tillë nuk qëndron.*

*5.4. Në shtojcën mbi ndryshimin e dokumenteve të tenderit, autoriteti Juaj kontraktor ka kërkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohet: të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:*

*1. 2 (dy) makina teknologjike përfshirjen e rrugëve ( fshesa mekanike ), te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qëndrore me sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatja me më gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës.*

*2. Borepastraese cope 2 ( dy), te jene te pajisura me mekanizmin e hedhjes se kripes.*

*3. Makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor per mbledhjen dhe evadimin e mbeturinave, me kapacitet mbajtes jo me pak se 10 ton, cope 4 (kater)*

*4. Makina kompatator per heqjen e mbeturinave ne lagjet pa kontenierjo me shume se 3,5 ton, cope 3 (tre)*

*5. Makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor per mbledhjen dhe evadimin e mbeturinave me kapacitet mbajtes deri ne 7 ton, cope 3 (tre).*

*6. Makina për larjen e rrugëve, (mjet teknollogjike) të pajisur me pompë për larjen e rrugëve me presion, pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesën anësore të tij, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10. 000 litra ujë, jo më pak se 1 (nje) copë;*
*7. Makina për lagien e rrugëve, (mjet teknollogjike) të pajisura me pompë për lagien e rrugeve,me kapacitet mbajtes jo më pak se 10.000 litra uje, jo më pak se 1 (nje) copë;*
*8. Fadrome me goma per heqjen e inerteve me kapacitet te koves jo me pak se 1 m3 ,eope 1 (një)*
*9. Traktor per shtytjen dhe ngjeshjen e mbeturinave ne fushe cope 1 (nje ) .*
*10. Makine transporti per mbetjet e riciklueshme (leter, plastike, qelq, alumin) me shenja dalluese, 1(nje cope)*
*11. Kamioncine per evadimin e mbetjeve inerte,) (nje)cope Dokumentacioni qe duhet te dorezohet per mjetet e mesiperme :*
*-Ne rast se jane ne pronesi duhet te paraqiten, certifikata e pronesise , leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit.*
*-Knr jane me qera te paraqiten: kontrata e qerase vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekti ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit, certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit.*
*Ne rast se mjetet nuk jane ne pronesi apo me qera mund te paraqiten Akt Marrëveshje porosie/Kontratë e ,Porosie/kontrate leasing/ ose marreveshje per shitjen me kusht te mjeteve Kontratat dhe marreveshjet e sipercituara duhet te jene lidhur perpara noterit dhe duhet të përmbajnë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e ny'etit, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës /marreveshjes si dhe afatin për ekzekutimin e saj.*
*“Operatori ekonomik duhet të paraqese per secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku te jete e dukshme dhe targa e mjetit.*
*Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve.*
*5.5. Në përmbushje të kriterit të mësipërm të kualifikimit, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rej” shpk & “TTA Alba Lam” shpk kanë lidhur akt marrëveshjen materiale nr.302 rep dhe nr.212 kol datë 14.02.2018 me shoqërinë Erka BMC 2007 e cila shfaqet në cilësinë e distrbutorit zyrtar të prodhuesve, Tatco, Ford Cukurova, Isuzi Hunday , Karsan për Maqedoninë dhe Ballkanin Perëndimor. Në lidhje me pretendimin tuaj të mësipërm të skualifikimit, konstatojmë se ky i fundit nuk ëshë i qartë, krijon konfuzion dhe nuk përmbush elementët e nenit 100 të Kodit të Procedurave Administrative e cila parashikon se akti administrative përfshirë edhe aktin për kualifikimin / skualifikimin e ofertës në një procedurë prokun‘mi duhet të jetë i arsyetuar. Autoriteti Juaj kontraktor ka dështuar të arsyetojë se cilën prej kritereve nuk përmbush mjeti i propozuar nga ana jonë, apo në rast se arsyeja e skualifrkimit lidhet me faktin se nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë janë porositur nga 3 në 4 mjete. Në hipotezën se arsyeja e skualifikimit lidhet me faktin se bashkimi ynë i operatorëve ekonomikë ka parashikuar të ketë në dispozicion 4 nga 3 mjete të kërkuara, mendojmë se pretendimi i mësipërm nuk mund të qëndrojë as logjikisht dhe as ligjërisht, pasi me synim ofrimin e plotë dhe me cilësië të shërbimit, bashkimi ynë i operatorëve ekonomikë ka porositur një mjet më shumë me synim shmangien e bllokimit të punës së ofrimit të shërbimit të pastrimit të qytetit. Në rast se pretendimi Juaj lidhet me faktin se nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar mjet me kapacitet mbajtës jo më shumë se 7 ton dhe nga ana jonë është ofruar me*

*kaapeitet të paktën 7 ton, sqarojmë se autoriteti juaj kontraktor po skualihkon ofertën tonë referuar kritereve të cilat nuk janë të parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit duke qenë një herezi në kundërshtim me nenin 55 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar ku parashikohet se "Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter. që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit." Gjithashtu, në rast se autoriteti juaj do të kishte paqartësi në lidhje me ofertën teknike të bashkimit të shoqërive në drejtim të plotësimit të kapacitetit teknik, atëherë kishit mundësi të drejtonit kërkesë për sqarime në përputhje me nenin 66 pika 2 të VKM 914/2014 ku parashikohet se "Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve. " Në rastin konkret ju nuk keni kërkuar sqarime në rast se ofertuesi ka deklaruar disponueshmërinë e 4 mjeteve me kapacitet total të mjetit jo më pak se 7 ton apo me kapacitet mbajtës jo më pak se 7 ton. Ndërkohë, referuar kritereve të veçanta të kualifikimit, autoriteti juaj kontraktor ka kërkuar disponueshmërinë e mjeteve me kapaciteti mbajtës deri në 7 ton duke përfshirë njëherazi edhe mundësinë që të gjithë mjetet të jenë me kapacitet mbajtës deri në 7 ton. Akoma më tej, shoqëritë tona kanë deklaruar në kontratën e porosisë kanë deklaruar mjete me kapacitet jo më pak se 7 ton, pra edhe me kapacitet mbajtës përmbushet kriteri i sipërcituar, por edhe në rastin se mjetet janë me kapacitet total 7 ton, atëherë kapaciteti mbajtës është më pak se 7 ton. Mjetet e propozuara nga ana jonë përmbushin kriteret e kualifikimit. Gjithashtu në nenin 2 të kontratës është shprehur qartësisht se kjo kontratë hartohet në përputhje me DST e procedurës së prokurimit zhvilluar nga autoriteti juaj kontraktor. Porositësi dhe i porosituri janë në dijeni të plotë të specifikimeve teknike të mjeteve dhe si e tillë, në cilësinë e distrbutorit të autorizuar të prodhuesit, mjetet do të prodhohen dhe janë në përputhje me Specitikimet Teknike.*

*Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese".*

*Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim, të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...". Gjithashtu, shoqërite kanë paraqitur deklaratë për verifikimin e mjeteve dhe në rast se nuk plotësohen kriteret, atëherë AK rezervon të drejtën të kualifikojë. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin KPP 50/2015 ku shprehet se "Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike në lidhje me mjetet e nevojshme që ka në dispozicion për realizimin e kontratës. III.2. 7. Referuar kërkesave të përcaktuara nga autoriteti [contra/(tor në dokumentat e tenderit, Shtojca 7, për mjetet dhe pajisjet, në paragrafin e fundit të të cilës përcaktohet se "Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor*

*rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmerise së mjeteve me apo pa lajmërim paraprak si dhe të bëjë deklarimin e adresës së saktë të vendodhjes së mjeteve me qëllim verifikimin e tyre operatori ekonomik "Alko Impex General Construcion " sh.p.k, i ka paraqitur këto deklarata ndaj edhe autoriteti kontraktor me vendosjen e kushtit të mësipërm ka rezervuar të drejtën vetes, që në çdo kohë mund të bëjë veripkimin fizik të mjeteve, e drejtë kjo e njohur edhe në legjislacionin për prokurimin publik. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 62 "Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës " të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e ti] ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjës thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik. është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. " Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.*

*5.6. Lidhur me pretendimin se: "Se treti : Ne kriteret e vendosura ne dokumentat e tenderit eshte percaktuar shprehimisht se : " Ne rast se mjetet nuk jane ne pronesi apo me qera mun paraqiten Akt Marrëveshje porosie/Kontratë e Porosia/kontrate leasing/ ose marreveshje per shitjen me kusht te ajeteve " Kontratat dhe marreveshjet e sipercituara duhet te jene lidhur perpara noterit dhe duhet të përmbajnë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit, të dhënat teknike për mjetin, kushte kontratës /marreveshjes si dhe afatin për ekzekutimin e sqi. " Ne aktmarreveshjen e dorezuar nuk ka te dhena teknike per mjetet por eshte percaktuar ne 4.6 te saj se "Bashkengjitur kesaj aktmarreveshje jane katalaget me te dhenat e sakta teknike dhe tipin e mjeteve dhe automjeteve" . Lidhur me sa me si sa kohe qe kataloget teknike jane pjese e aktmarreveshjes, duhet te ishin firmosur nga te tre palet e aktmarreveshjes dhe te ishin lidhur me vule lidhese noteri. Per sa kohe ato jane te firmosura vetem nga njera pale konkretisht shoqeria Erica BMC 2007 athere arrijme ne perfundimin se nuk ka nje konfirmim gjitha palet e marreveshjes lidhur me mjetet konkrete sipas te dhenave teknike qe jane kerkuar,.si nuk mund te merren ne shqyrtim kataloget me te dhen mjeteve te firmosur ne menyre te njeanshme ." vlerësojmë se nuk është I bazuar në ligj dhe i referohet një kriteri të pa kërkuar sa më sipër nuk qëndron.*

*5.7. Në shtojcën mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit është kërkuar "Ne rast se mjetet nuk jane ne pronesi apo me qera mund te paraqiten Akt Marrëveshje porosie/Kontratë e Porosia/kontrate leasing/ ose marreveshje per shitjen me kusht te mjeteve .Kontratat dhe marreveshjet e sipercituam duhet te jene lidhur perpara noterit dhe duhet të përmbajnë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës lmarreveshjes si dhe ajhtin për ekzekutimin e saj.-Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku tëjetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

*Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve. " Nënvizojmë se nga ana e autoritetit tuaj kontraktor nuk është kërkuar në asnjë rast dorëzimi i katalogut në rast se mjetet janë me kontratë porosie dhe mbi të gjitha se katalogu duhet të jetë i firmosur nga palët. Është kërkuar vetëm deklarimi i specifikimeve teknike të qarta të mjeteve të cilat janë deklaruar në kontratën e bashkëpunimit. Sa më sipër, arsyeja e skualifikimit i referohet një kriteri të pa kërkuar dhe ndodhemi në kushtet e nenit 55 pika 2 "të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar ku parashikohet se*

*“Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën jituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit. ” Akoma më tej, katalogu i mjeteve i deklaruar nga ana jonë dhei dorëzuar në këtë procedurë prokurimi është një akt i prodhuesit dhe te drejten e firmës mbi të e ka prodhuesi ose distrnbutori i autorizuar prej tij dhe në asnjë rast palët nuk mund të nënshkruajnë mbi katalogun e një prodhuesi kur ne nuk shfaqemi as në rolin e distrubutorit të autorizuar dhe as të prodhuesit. Ne si shoqëri kemi nënshkruar Shtojcën mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike ku kemi deklaruar se kemi marrë dijeni për specifikimet teknike, përfshirë edhe të mjeteve, i kemi pranuar dhe plotësuar me anë dokumentacionit të dorëzuar.*
*Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.*
*5.8. Lidhur me pretendimin se: "Se katerti: Lidhur me mjetet e deklaruara me qera nga Shoqeria REJ sh.p.k: -Kontrata e qerase per fat/rom goma e lidhur ndermjet shoqerise "REJ“ dhe “Flamur Hoxhaj " nuk eshte vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimit qe kerkohet ne dokumentat e tenderit. Eshte percaktuar qe afati I kontrates te qerase do te jete 5 vjet nga data e kontrates. Data e kontrates te qerase esht 01.02.2018. Pra perfundon ne 01.02.2023,rrjedhimisht para perfundimit te kontrates qe do te lidhet per kete objekt. GJithashtu kontrata e qerase nuk esh para noterit. -Kontrata e qerase per kamioncinen e lidhur ndermjet shoqerise “REJ” dhe Z.E.Suli nuk eshte vlefshme per te gjithe periudhen e realizim kontrates objekt i ketij prokurimi sic kerkohet ne dokumentat e tenderit. Eshte percaktuar qe afati I kontrates te qerase do te jete 5 vjet nga data e kontra Data e kontrates te qerase eshte 31.01.2018. Pra perfundon 31.01.2023, rrjedhimisht para perfundimit te kontrates qe do te lidhet per kete objekt. Gjithas kontrata e qerase nuk eshte lidhur para noterit” vierësojmë se nuk është I bazuar në ligj dhe i referohet një kriteri të pa kërkuar sa më sipër nuk qëndron.*
*5.6. Në shtojcën mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit është kërkuar Kur jane me qera te paraqiten: kontrata e qerase vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt :" ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit ,certifikaten e pronesise, certifikate): e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit. ” Së pari në lidhje me pretendimin se për mjetin tip fadrome me goma, kontrata e qerase nuk eshte noteriale, sqarojme se referuar KVK ne asnje rast nuk parashikohet se kontrata e qerasë duhet të jetë notenale, por parashikohet vetëm fakti see në rast se mjetet janë me kontratë qeraje. Në nenin 55 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20. i 1.2006 “Për prokurimin publik" të ndryshuar ku parashikohet se “Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit. " Sa më sipër, autoriteti juaj kontraktor po skualifikon ofertën e shoqërisë tonë duke iu referuar një kriteri i cili nuk është kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit. Akoma më tej, kontrata e mësipërme është lidhur në përputhje me parashikimet e Kodit Civil. Neni 801 i Kodit Civil parashikon se Qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t’i japë pales tjeter (qiramarrësit) një send të caktuar, në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar. Pra, referuar Kodit Civil nuk parashikohet se kontrata e qerasë duhet të jetë noteriale si element i vlefshmërisë së saj. Pra, që të kërkohet kontratë noteriale, duhet të përmbushen kuhtet e nenit 197 të Kodit Civil ku parashikohet se Duhen*

*të regjistrohen gjithashtu: a) kontratat e qiradhënies së sendeve të paluajtshme për një kohë mbi nëntë vjet; ndëkrohë, në rastin konkret kontrata qe qerasë është 5 vjet ndaj nuk shfaqet nevoja te jetë noteriale. Në lidhje me pretendimet për afatin e vlefshmërisë së kontratës, nënvizojmë se afati i qerasë së kontratës me z. F. Hoxhaj dhe E.Suli është me kusht, pra 5 vjet nga data e lidhjes së kontratës duke përfshirë njëherazi të gjithë kohëzgjatjen e kontratës. Gjithashtu, kriteri plotësohet edhe vetëm me kontratën e porosisë ku është deklaruar disponueshmëria e një mjeti tip fadromë me goma, për të cilën ju si autoriteti nuk keni ngritur në asnjë rast pretendime.*
*5.9. Lidhur me pretendimin se : Gjithashtu nisur nga sherbimet konkrete qe ka marre persiper te kryeje shoqeria Rej konkretisht: "Pastrim nga Debora+lmposje " "Mbledhje transport mbeturinash fshati ", duhej qe shoqeria Ref sh.p.k te dispononte te pakten dy borepastruese dhe tre makina tek transportuese me ngarkim jimdor per mbledhjen dhe evadimin e mbeturinave, me kapacitet mbajtes deri ne 7 ton, per trasportin e mbeturinave te jihatitisie eshte percaktuar ne specifikimet teknike. Gjykojmë se nuk është i bazuar në fakt dhe në ligj dhe si i tillë nuk qëndron.*
*5.10. Në shtojcën mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës se prokurimit autoriteti juaj kontraktor ka parashikuar: Borepastruese cope 2 ( dy ), te jene te pajisura me mekanizmin e hedhjes se kripes. 3. Makina teknologjike transportuese me ngarkim jimdor per mbledhjen dhe evadimin e 5. Makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor per mbledhjen dhe evadimin e* mbeturinave, me kapacitet mbajtes deri ne 7 ton, cope 3 ( tre ) .
*5.11. Në përmbushje të kriterit të mësipërm të kualifikimit, bashkimi i operatorëve ekonomikë "Rej" shpk & "TTA Alba Lam" shpk kanë lidhur akt marrëveshjen noteriale nr.302 rep dhe nr.212 kol datë 14.02.2018 me shoqërinë Erka BMC 2007 e cila shfaqet në cilësinë e distrbutorit zyrtar të prodhuesve, Tatco, Ford Cukurova, Isuzi Hunday , Kaisan për Maqedoninë dhe Ballkanin Perëndimor. Referuar kontratës së sipërcituar është kryer porosia dhe disponueshmëiia një herezi në rast të nënshkrimit të kontratës të 3 mjeteve tip borëpastmese si edhe të 4 mjeteve tip makina tranpostuese për mbledhjen dhe evandimin e mbeturinave. Nënvizojmë se vlerësimi i ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë kryhet në përputhje me kriteret e tenderit, nenin 46,53,S4,55 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Përprokurimin publik" të ndryshuar si edhe nenin 74 të VKM 914/2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Sa më sipër, në kontratën e porosisë dhe në përputhje me përqindjen e bashkëpunimit dhe elementët konkretë të bashkëpunimit, shoqëria "Rej" shpk disponon kapacitetin teknik dhe mjetet e nevojshme përkryerjen e shërbimit.*
*Sa më sipër pretendimi nuk qëndron.*
*Gjithashtu theksojmë se edhe KPP gjithmonë ka arsyetuar se Autoriteti Kontraktor duhet të udhëhiqet nga parimi i mirëpërdorimit të fondeve publike dhe përfitimi i një produkti me cilësi të mirë dhe me çmim më të ulët, si edhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, aq më tepër në kushte kur kemi një përcaktim të qartë të kritereve dhe dokumentacionit që duhet të paraqitet, dokumentacion ky i cili provohet më së miri se operatori ekonomik ankimues e disponon. […]".*
III.2.5. Autoriteti kontrator në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues argumenton se: "*KSHA konstatoi se:*

1. *Për plotesimin e kriterit te vendosur per mjetet bashkimi i shoqerive Rej sh.p.k dhe T.T.A ALBALAM sh.p.k ka paraqitur:*

*Deklarate mbi disponueshmerine e mjeteve*

*Deklarate mbi verifikimin e mjeteve*

*Aktmarreveshje noteriale per sigurimin e mjeteve lidhur ndermjet bashkimit te shoqerive Rej sh.p.k dhe T.T.A ALBALAM sh.p.k dhe shoqerise Erka BMC 2007 sh.p.k*

*Kontrate qeraje per fadromen me goma e lidhur ndermjet shoqerise "REI" dhe "Flamur Hoxhaj*

*Kontratën e qerasë për kamioncinën e lidhur ndërmjet shoqërisë Rej dhe Z. Engjell Suli*

*Vërtetim zhdoganimi traktori*

2. *Lidhur me aktmarrëveshjen për mjetet në kriteret e vendosura në dokumentat e tenderit është parashikuar shprehimisht: […]*

*Në aktmarrëveshjen noteriale për sigurimin e mjeteve lidhur ndërmjet bashkimit të shoqërive Rej dhe TTA Alba Lam dhe shoqërisë Erka BMC 2007 në pikën 4.3 është përcaktuar si më poshtë:*

*4.3. […]*

*Në kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit është përcaktuar ndër të tjera që marrëveshja duhet të përmbajë të dhëna të sakta në lidhje me tiipin e mjetit, të dhënat teknike për mjetin.*

*Nga krahasimi I të dhënave teknike të kërkuara për mjetet dhe ato të shënuara në aktmarrëveshje rezulton se nuk ka të dhëna teknike të plota për mjetet në mënyrë që të gjykohet që ato janë në përputhje me specifikimet të kërkuara për mjetet.*

*Sic shihet dhe ne tabelen përmbledhëse, karakteristikat e mjetit të shenuara me "bold" dhe te nenvizunra mungojne ne aktmarrëveshje. Per sa me siper KSHA arrin ne perfundimin se aktmarrëveshja per mjetet nuk përmban të dhëna te sakta në lidhje me tipin e mjetit dhe të dhënat teknike ne perputhje me dokumentat e tenderit. Pra nuk qendron pretendimi nnkuesit se ne aktmarrëveshjen e mjeteve janë deklaruar specifikime të qarta të mjeteve. Duke qenë se ne aktmarreveshje eshte cituar se "lista/tipi autmjeteve dhe kamionave eshte bashkelidhur me kete aktmarreveshje" cka nenkupton se eshte pjese e aktmarreveshjes, dhe ne kushtet kur ne pershkrimin e bere ne akmarreveshje mungonin karateristikat e disa prej mjeteve atehere me te drejte KVO ka verfikuar kataloget bashkelidhur. Per sa me siper verifikimi katalogeve ne kete rast nuk mund te interpretohet si verifikim i nje dokumenti te pa kerkuar. Ne rast se pranojme pretendimin e operatorit se kataloget nuk duhet te merren fare ne shqyrtim per arsye se nuk jane kerkuar atehere arrijme ne perfundimin se ne kushtet kur aktmarreveshja per mjetet nuk permban karakteristikat e kerkuara per mjetet, bashkimi i operatoreve nuk permbush kriterin e kerkuar per mjetet. Duke qene se palet kane cituar se "lista/tipi automjeteve dhe kamioneve eshte bashkelidhur me kete aktmarreveshje" nga verifikimi i dokumentacionit qe i eshte bashkelidhur aktmarreveshjes rezulton se per sa kohe qe ky dokumentacion nuk ka vule lidhese nga noteri apo konfirmim nga te gjitha palet se behet fjale per te njejtat mjete te cituara ne aktmarreveshje atehere ato nuk mund te merren ne shqyrtim per te vertetuar se permbushin karakteristikat e kerkuara ne dokumentat e tenderit.*

*Per sa me siper nuk qendron pretendimi i ankuesit nuk qendron.*
*Lidhur me mjetet e deklaruara me qera apo në pronësi të shoqërisë REj shpk KSHA Vlerëson se:*
*Nisur nga shërbimet konkrete që ka marrë përsipër të kryejë shoqëria Rej shpk*
*"Pastrim rrugesh nga Debora+kriposje",*
*"Mbledhje transport mbeturinash fshati"*
*"Larje e kontenierеve + dizinfektim"" duhej qe shoqeria Rej sh.p.k te dispononte te pakten dy borepastruese dhe tre makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor per mbledhjen dhe evadimin e mbeturinave, me kapacitet mbajtes deri ne 7 ton, per trasportin e mbeturinave te fshatit,sic eshte percaktuar ne specifikimet teknike.*
*Per sa me siper vlefshmeria e dokumentacionit te paraqitur per mjetet "Fadrome me goma", kamioncine, apo traktor, nuk ka asnje vlere sepse edhe sikur dokumentacioni te jete i vlefshem ai nuk sherben per kualifikimin e kesaj shoqerie sepse jane mjete qe nuk kane lidhje me sherbimet qe shoqerin "Rej" sh.p.k ka marre persiper te kryeje sipas aktruarreveshjes te bashkepunimit.*
*1._ Lidhur me vleresimin e bere nga KVO per kontraten e bashkepunimit : "Ne Kontraten e bashkepunimit te shoqerive Rej sh.p.k dhe 'TTA ALBA LAM sh.p.k , pika 13 e kesaj kontrate ku percaktohet se " Kapaciteti ekonomik dhe teknik (mjetet dhe stafi teknik etj)] shoqerise Rej sh. p. k, do te jete ne dispozicion te bashkimit te operatoreve "TTA Alba Lam "sh.p.k dhe "Rej" sh.p.k ne rast se ky bashkim operatoresh shpallet fitues .Per kete arsye nuk eshte pare e arsyeshme te behen kontrate qeraje per mjetet qe do te perdoren ne kete kontrate. Gjithashtu eshte e vlefshme edhe e anasjellta. " eshte ne kundershtim me percaktimin e bere në nenin 74 pika 3 te VKM 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publiK" ku percatohet si me poshte: -Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi. në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes për punë Shërbim apo furnizim të përcaktuara në aktmarrëveshje. Persa me siper duke qene se ne aktmarrevshjen noteriale te lidhur per furnizimin me makineri nuk eshte bere ndarja e tyre por marreveshja eshte bere nga bashkimi i shoqerive nuk mund te gjykohet nese sejcili nga anetaret e bashkimit e permbush kriterin e mjeteve ne perputhje me perqindjen qe ka marre persiper ne marreveshjen e bashkepunimit. " KSHA,vlereson se ne kushtet kur: -Ne nenin 74 pika 3 te VKM 914 date 29.12.2014 te cituar me siper vleresimi i permbushjes te kritereve nga sejcili prej anetareve te bashkimit te shoqerive behet në përputhje me përqindjen e vo'esëmarr'es në "më shërbim ato itrnizim, të aërcaktuara në akt marrëvesh 'e. -Percaktimi i bere ne piken 13 te kontrates te bashkepunimit te shoqerive_Rej sh.p.k dhe T.T.A ALBALAM sh.p.k ,te siper cituar, eshte ne kundershtim me me nenin 74 pika 3 te VKM 914 date 29.12.2014. Ne aktmarreveshjen noteriale te lidhur per furnizimin me makineri nuk eshte bere ndarja e tyre por marreveshja eshte bere nga bashkimi i shoqerive, atehere nuk mund te gjykohet nese sejcili nga anetaret e bashkimit e permbush kriterin e mjeteve ne*

*perputhje me perqindjen dhe elementet konkrete qe ka marre persiper ne marreveshjen e bashkepunimit.*

III.2.6. Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive të mësipërme rezulton se ka mangësi në plotësimin e kriterit për mjetet. Konkretisht, nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se, në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve ekonomikë ”Rej” sh.p.k. dhe ”TTA Alba Lam” sh.p.k. përvec përcaktimit të përqindjes dhe ndarjes së zërave të shërbimeve konkrete që do të kryejë secili, në pikën 13 të saj, është përcaktuar: *”Kapaciteti ekonomik edhe teknik (mjetet edhe stafi teknik etj) i shoqërisë Rej sh.p.k. do të jetë në dispozicion të bashkimit të operatorëve ”T.T.A. Alba Lam” sh.p.k. & ”Rej” sh.p.k. në rast se ky bashkim operatorësh shpallet fitues. Për këtë arsye nuk është e paraë e arsyeshme të bëhen kontrata qeraje për mjetet që do të përdoren në këtë kontratë. Gjithashtu është e vlefshme edhe e anasjellta”.*

III.2.7. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: “*Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi*”. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: “*Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokure përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi…”,* ndërsa në pikën 3 parashikohet: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*”.

III.2.8. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*” Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.2.9. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kritereve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rej” sh.p.k. & “TTA AlbaLam” sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në

dokumentat e tenderit, pasi, kontrata e bashkëpunimit nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi si më sipër  cituar. Komisioni i Prokurimit Publik, ashtu siç edhe vetë operatori ekonomik ankimues sqaron, referuar vendimmarrjes së këtij të fundit, gjykon se operatorët ekonomikë të cilët vendosin të konkurojnë si një bashkim operatorësh ekonomikë në një procedurë prokurimi, duhet ta zyrtarizojnë këtë bashkim nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, në të cilën kanë detyrimin të përcaktojnë pjesën e shërbimit, punës ose furnizimit që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, ndërsa kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuar në këtë kontratë. Në rastin konkret, detyrimi i vetëm ligjor që duhet zbatuar në mënyrë që kjo kontratë bashkëpunimi të konsiderohet e vlefshme, konsiston në deklarimin në përqindje të shërbimeve, si dhe i zërave konkret të preventivit të shërbimeve, që secili operator ekonomik merr përsipër të kryejë, ndërsa në lidhje me përmbushjen e kërkesave ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike, nuk është e detyrueshme që të deklarohet përqindja apo mënyra e kontributit, pasi bazuar në nenet e sipërcituara, ato përllogariten në mënyrë përpjestimore me përqindjen e deklaruar për punët që do të kryejë gjithsecili. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, referuar kontratës së bashkëpunimit dhe përcaktimit të bërë në pikën 7 të kësaj kontrate, ku deklarohet ndarja e përqindjes dhe e zërave që merr përsipër secili anëtar i këtij bashkimi operatorësh, plotësimi i kritereve do t'i referohet kësaj ndarje, ndërsa deklarimi se ”Kapaciteti ekonomik dhe teknik (mjetet dhe stafi teknik etj) shoqerise Rej sh. p. k, do te jete ne dispozicion te bashkimit te operatoreve "TTA Alba Lam ”sh.p.k dhe "Rej" sh.p.k ne rast se ky bashkim operatoresh shpallet fitues*”*, konsiderohet një deklarim shtesë jo i domosdoshëm dhe si i tillë nuk duhet të merret në konsideratë, në lidhje me plotësimin e kritereve të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Nisur nga përqindja e përcaktuar në këtë kontratë, si edhe zërat e shërbimeve të marra përsipër nga secili prej anëtarëve, do të bëhet edhe verifikimi i përmbushjes së kërkesave dhe kritereve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

III.2.10. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në sistemin e prokurimeve elektronike për këtë procedurë prokurimi, në lidhje me mjetet, konstatohet se operatori ekonomik ankimues në dokumentin Akt marrëveshje të nënshkruar ndërmjet palëve ”Rej” sh.p.k., ”TTA Alba Lam” sh.p.k.,”Erca BMC 2007” sh.p.k., ka deklaruar se do të ketë në dispozicion makineri teknologjike transportuese jo më pak se 7 ton, duke kuptuar që kapaciteti minimal do të jetë 7 ton, ndërkohë që në dokumentat e tenderit kjo makineri është kërkuar me kapacitet mbajtës jo më shumë se 7 ton, pra nga autoriteti kontraktor për arsye të konsideruara të nevojshme prej tij dhe të argumentuara, është kërkuar që makineria teknologjike transportuese të jetë maksimumi 7 ton, fakt ky dhe kriter i mirëpërcaktuar dhe parashikuar në dokumentat e tenderit.

Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga ky fakt, gjykon të ndalet në analizimin edhe të vlefshmërisë së dokumentit akt marrëveshje, pasi kjo aktmarrëveshje e lidhur ndërmjet tre shoqërive, pra dy shoqërive anëtare të bashkimit të operatorëve ekonomikë dhe shoqërisë Erca BMC 2007, nuk arrin të bëjë të identifikueshëm pjesën që do të ketë secili operator ekonomik anëtar i këtij bashkimi, me qëllim verifikimin e përmbushjes së kriterit të mjeteve në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit dhe zërat e shërbimeve që do të kryejë

secili. Pra, në rastin konkret, me dokumentacionin e paraqitur, nuk është e mundur të bëhet vlerësimi për plotësimin e kriterit të operatorit ekonomik ankimues në lidhje me mjetet, sipas përqindjes së përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit, në kushtet kur akt marrëveshja për mjetet është lidhur ndërmjet një shoqërie distributore dhe dy anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, pa përcaktuar madje as se cilat mjete do t'i jepen kujt.

Gjithashtu, në lidhje me pretendimin përsa i përket katalogëve, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se këta katalogë, si pjesë e akt marrëveshjes së hartuar dhe nënshkruar nga të tre palët, duhet të ishin të nënshkruar nga të tre shoqëritë respektive. Në dokumentat e tenderit, nga ana e autoritetit kontraktor, është përcaktuar që, operatorët ekonomikë mund të paraqesin marrëveshje porosie të cilat duhet të jenë të lidhura para noterit dhe të përmbajnë të dhëna të sakta në lidhje me tipin e mjetit, të dhënat teknike për mjetin. Referuar dokumentacionit të ankimuesit, konstatohet se, në akt marrëveshjen e paraqitur nga ankimuesi, në pikën 4.6. të saj është përcaktuar që *"Bashkengjitur kesaj aktmarreveshje jane katalaget me te dhenat e sakta teknike dhe tipin e mjeteve dhe automjeteve".* Në këto kushte, kur të dhënat teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, mungojnë në akt marrëveshjen e lidhur, atëherë katalogët të cilët, në këtë akt marrëveshje, është përcaktuar që janë pjesë e saj, edhe ato duhet të ishin të nënshkruara nga të tre palët, ashtu siç nënshkruar të gjitha faqet e tjera të kësaj marrëveshje, si pjesë integrale e saj. Në rast se të dhënat teknike do të ishin të përcaktuara në akt marrëveshje, do të konsiderohej i plotësuar kriteri, përsa kohë që, kjo aktmarrëveshje, në të cilën do të ishin përcaktuar këto të dhëna teknike, do të ishte e nënshkruar nga të gjitha palët.

III.2.11. Përsa i përket pretendimit të ankimuesit në lidhje me mjetet borëpastruese dhe mjeteve për transportin e mjeteve, sqarojmë se, referuar përqindjes dhe zërave të shërbimit të marra përsipër nga ana e operatorit ekonomik "Rej" sh.p.k., ky i fundit ka detyrimin të përmbushë kriterin për mjetet e mësipërme, referuar kjo pjesës së shërbimeve të marra përsipër nga kjo shoqëri. Edhe vetë operatori ekonomik ankimues në lidhje me këtë arsye skualifikimi nuk jep fakte e argumenta, por thjesht citon faktin se ka një akt marrëveshje ku janë deklaruar makineritë teknologjike dhe borëpastrueset dhe se në përputhje me përqindjen e bashkëpunimit plotësohet ky kriter. Referuar arsyetimeve të mësipërme, në kushtet kur akt marrëveshja është lidhur në total dhe në tërësi me të dyja shoqëritë, anëtare të bashkimit të operatorëve ekonomikë, pa u detajuar apo ndarë se cilat mjete vihen në dispozicion nga shoqëria Erca BMC2007, për cilën shoqëri, gjykojmë se, operatori ekonomik "Rej" sh.p.k. nuk ka arritur të vërtetojë me dokumentacion përmbushjen e kriterit për mjetet, në përputhje me pjesët e shërbimit të marra përispër.

Sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur në lidhje me përmbushjen e kriterit për mjetet, nuk është në përputhje me kërkesën e përcaktuar në dokumentat e tenderit, si edhe me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

III.2.12. Në Kreun VIII, neni 74, "Bashkimi i operatorëve ekonomikë", pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet: "*Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi".* Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: "*Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen*

*përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokure përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi…*”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*”.

III.2.13. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.2.14. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kritereve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor, duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rej” sh.p.k. & “TTA AlbaLam” sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, për mjetet, për shkak të mangësive të evidentuara më sipër.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

III.2.15. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se, autoriteti kontraktor nuk ka qenë në kushtet e nenit 53, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar. Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo

Open Procurement Albania

ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e ankimuesit në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.
III.2.16. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kerkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedurial të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar parashikohet se *"Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni".*
Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementësh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me intepretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kritereve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedurial të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së.
Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se *"[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]".*

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Në lidhje me pretendimet e tjera të bashkimit të operatorëve ekonomikë "Rej" sh.p.k. & "T.T.A Alba-Lam" sh.p.k., për skualifikimin e padrejtë të tij, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i janë pranuar disa prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori nuk do të ndryshojë, por do të mbetet i skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke mos përmbushur interest e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"*, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 "*Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë "Rej" sh.p.k. & "T.T.A Alba-Lam" sh.p.k. për procedurën e prokurimit "*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar"*, me nr. *REF-33925-11-13-2017,* me objekt*: "Pastrimi evadimi i mbetjeve urbane në Bashkinë e Korçës (Shërbimi i pastrimit)",* me fond limit 356.843.945 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedures së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 636 Protokolli**
**Datë 28.03.2018**

Open Procurement Albania

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

| Zv/Kryetar | Anëtar | Anëtar | Anëtar |
|---|---|---|---|
| **Leonard Gremshi** | **Hektor Balluku** | **Kleves Janku** | **Odise Moçka** |

**Kryetar**
**Evis Shurdha**